

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.7(397)

KORRIK 2021 ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

10 KORRIKU

## NGJARJE KULMORE NË HISTORINË E LANÇ




Nga RRAHMAN PARLLAKU

FAQE 2

DEKRETI

## MANUSHAQE SHEHU, E VETMJA GRUA SHQIPTARE ME GRADËN MADHORE "GJENERAL MAJOR"



FAQE 7

NËNKRYETARI I OBVL

## "MJESHTËR I MADH", TITULLI MERITUAR PËR MUHARREM GJOKËN



Nga Halil RAMA

FAQE 12

*Stërvitja që hap një rrugë të re entuziazmuese për një bashkëpunim më të madh strategjik*

# "Defender Europë 2021", stërvitja më e madhe e tri dekadave të fundit në Shqipëri

## SHBA dhe Shqipëria, krah për krah, përgjithmonë

Yuri Kim\*

"Defender Europe 2021", është stërvitja më e madhe ushtarake e udhëhequr nga SH.B.A. që Ballkani Perëndimor ka parë ndonjëherë! Ky është piketë referimi për bashkëpunimin SHBA-Shqipëri në mbrojtje. Është gjithashtu një moment historik referimi për Aleancën e NATO-s. Kjo Stërvitje është në zhvillimin e sipër dhe po merr trajtën e një suksesi të madh. "Defender 21" ka qenë një sukses ushtarak.

Në javët e fundit, ushtarë nga Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Kosova, Mali i Zi, Hollanda, Maqedonia e Veriut, Rumania, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara janë stërvitur së bashku për të forcuar gatishmërinë, aftësitë dhe ndërveprueshmërinë tonë në mënyrë që Aleatët dhe Partnerët e NATO-s të mund të kryejnë çdo mision në tokë, përtej detit dhe në ajër. Gatishmëria, aftësitë dhe ndërveprueshmëria jonë garantojnë parandalimin e konfliktit, ruajtjen e paqes dhe mbajtjen e kombeve tona të sigurta. Për më tepër, "Defender 21" ka hedhur bazat për një bashkëpunim edhe më të fortë në vitet në vazhdim. Kam patur mundësinë të vizitoj shumë nga vendet e trajnimit në Shqipëri. Në çdo vendndodhje, gjëja e parë që shoh është shqiptarë dhe amerikanë, që punojnë së bashku dhe që po njihen me njëri-tjetrin. Marrëdhëniet profesionale dhe vetjake që po formohen tani e tejkalojnë trajnimin ushtarak – ato forcojnë lidhjet tona.

(Vijon në faqen 3)



### • YURI KIM:

*"Marrëdhëniet profesionale dhe vetjake që po formohen tani e tejkalojnë trajnimin ushtarak – ato forcojnë lidhjet tona. Ushtarët tanë në uniformë ndihen saktësisht sikurse ndihemi ne diplomatët, të veshur me kostume, për këtë vend: Ata mrekullohen me bukurinë e Shqipërisë, vlerësojnë mikpritjen e ngrohtë të popullit shqiptar dhe janë krenarë që Shtetet e Bashkuara e quajnë Shqipërinë një mik dhe Aleat"*

LIBRI



SAKIP CAMI

## Mos ma prekni lumin tim

Një rrëfim historik i autorit Sakip Cami për luftërat, eksodet dhe epidemitë e viteve 1912 – 1920

## "Mos ma prekni lumin tim"

Ahmet Prenci, recensent i librit

FAQE 11

85 VJETORI

## XHEMAL MEÇI, STUDIUESI QË NUK NJEH MOSHË!

Ing. Kol DEDAJ-Studiuues

FAQE 6

PROFILI

## SHPENDI TOPOLLAJ, NJË JETË DUKE SHKRUAR...

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

FAQE 10

HISTORIA

## BAJO KAZO – LUFTËTAR LABËRIE QË GJAKUN E FALI PËR MËMËDHENË

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

AC

FAQE 8-9

## 10 KORRIKU

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve

# Ngjarje kulmore në historinë e LANÇ

Nga **RAHMAN PARLLAKU\***

Viti 1943 shënoi rritje në përmasa të mëdha të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në gjithë vendin ishin krijuar njësitë guerile, çeta e batalione partizane. Luftimet zhvilloheshin jo të veçuara nga çetat e batalionet, por të përbashkëta e të koordinuara brenda qarkut.

Po në korrik të atij viti, filluan të zhvilloheshin veprime luftarake të përbashkëta edhe në mes qarqeve të ndryshme, siç ishin luftimet e Përmetit, ku morën pjesë forcat e Gjirokastrës, Korçës e Beratit. Shtimi i radhëve të Ushtrisë partizane, çlirimi i krahinave të ndryshme, jehona e luftës së përhapur në të gjithë vendin u ndien edhe në botën e jashtme dhe u vlerësuan nga Fuqitë e Mëdha të Aleancës Antifashiste.

Ata e njohën Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm, Zonës së Parë Operative, qarqeve e njësitë që ta ndiqnin nga afër e ta ndihmonin atë. Ky nivel i ri i Luftës Antifashiste kërkonte që Ushtria të kishte një strukturë të re organizative, të njëjtë si për repartet sulmuese dhe territoriale, ashtu edhe për krijimin e njësitë taktiko-operative për veprime në të gjithë vendin. Rritja sasiore dhe cilësore e ushtrisë kërkonte drejtim unik dhe bashkërendim të veprimeve luftarake në shkallë vendi.

## HAP CILËSOR NË DREJTIM TË LUFTIMEVE

Në këtë shkrim nuk kam marr përsipër të flas gjatë për fillnisjen dhe vazhdimësinë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, pasi kjo u takon historianëve, por të përkujtoj e të them diçka për një nga datat më të rëndësishme në historinë e Ushtrisë Shqiptare, atë të krijimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjykoj se kjo datë do të zërë vendin e merituar në analet e historisë së kombit tonë.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm, 75 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqendruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i pajisur me kulturë ushtar-



ake. Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve, u bë kalimi nga një ushtri partizane me bazë rajonale në një ushtri mbarëkombëtare me strukturë organizative, që t'i përgjigjej jo vetëm stadi të arritur, por edhe perspektivës së kalimit në ushtri të rregullt. Shtabi i Përgjithshëm mori masa të menjëhershme për organizimin e strukturave ushtarake si të forcave operative, territoriale dhe të administratës ushtarake. Në forcat operative hynin brigadat sulmuese, që ishin të destinuara të vepronin në gjithë hapësirën e territorit të vendit dhe forcat territoriale, që vareshin nga komandat e qarqeve.

Në krahinat e çliruara, qarqet kishin krijuar organet administrative ushtarake, komandat e vendit në krahina, spitale, depo furnizimi etj.. Ky organizim ushtarak e justifikoi plotësisht veten në realizimin e detyrave luftarake nga njësitë e repartet, ku u kombinua mirë drejtimi nga Shtabi i Përgjithshëm me iniciativën e gjerë në veprimet luftarake nga vetë komandat e njësitë e reparteve, komandat e qarqeve dhe të Zonës së Parë Operative që përfshinte qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë. Kjo iniciativë ishte mëse e domosdoshme, pasi luftimet zhvilloheshin pa front të rregullt,

mjete teknike të ndërlydhjes e drejtimit mungonin, kryesisht, komunikimi me Shtabin e Përgjithshëm me ndërprerje të gjatë kohe.

## PARTIZANËT PËRBALLUAN VËSHTIRËSI MBINJERËZORE

Shtabi i Përgjithshëm, me gjithë kushtet tepër të vështira në të cilat vepronin dhe mungesën që kishte për ushtarakë të mirëfilltë, përgatiti e dërgoi disa udhëzime normative për rregullimin e jetës në reparte, drejtimin e luftimit, rregullin e disiplinën ushtarake, të kombinimit të disiplinës së ndërgjegjshme në zbatimin e detyrave etj.. Është me vend të theksojmë se kjo ishte disiplinë shembullore, e vetëpranuar jo vetëm në marrëdhëniet mes luftëtarëve, por edhe me popullin dhe nuk e thyenin atë qoftë edhe kur duhej dhënë jeta.

Masat organizative dhe ushtarake që mori Shtabi i Përgjithshëm, përgatitja dhe edukimi i forcave partizane me ndjenjën e lartë të përgjegjësive për çlirimin e vendit nga zaptuesit, i bënë repartet dhe njësitë e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare të përballojnë vështirësi, do të thosha mbinjerëzore.

Vetëm ai që ka përballuar vështirësitë e Operacionit Nazist të Dimrit 1943-'44 e di fort mirë këtë, të tjerët vështirë ta kuptojnë. Kjo përgatitje shpirtërore dhe vendosmëri për kalimin e vështirësive bëri që repartet e njësitë e dështuara rëndë ta marrin shumë shpejt veten në pranverën e vitit 1944 e të hidhen në sulm, që e befasoi keqas armikun. Këtë e kanë shprehur edhe përfaqësuesit e aleatëve në shkrimet e kujtimet e tyre, shumë prej të cilëve kanë ardhur edhe në Shqipëri.

## NDRYSHIMET ORGANIZATIVE ISHIN TË KARAKTERIT OPERATIVO-STRATEGJIK

Shtimi i shpejtë i reparteve e njësitë të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, sidomos krijimi i brigadave sulmuese, veprimet e tyre luftarake në hapësira të mëdha të territorit, çlirimi i shumë krahinave të vendit, i mbylli nazistët në qytetet dhe në ruajtjen e disa pikave bregdetare e të rrugëve kryesore.

Në këto kushte, Shtabi i Përgjithshëm mori masa për ndryshime organizative e të drejtimit të njësitë që ishin të karakterit operativ-strategjik, ndryshime në zhvillimin e veprimeve luftarake, kalimin nga luftimet pa front të rregullt në kryerjen e luftimeve dhe operacioneve në front të gjerë.

Këto masa të parashikuara nga Shtabi i Përgjithshëm, u aprovuan në Kongresin Antifashist të Përmetit më 24 Maj 1944. Kështu u krijua Komanda e Përgjithshme, u vendosën gradat ushtarake, u krijuan njësitë operative strategjike. Të gjitha këto masa i jepnin Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare karakterin e një ushtrie të rregullt, me perspektivë për kalimin në mësymjen e përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit.

Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqendroi në duart e tij edhe shumë detyra të tjera si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të Kryeministrit, të ministrit të Jashtëm etj.. Por siç dihet, ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgatitura, si dhe komandat e njësitë e të reparteve.

Nazistët e bashkëpunëtorët e tyre bënë tentativën e fundit në shkallë të madhe me Operacionin e Qershorit '44, duke grumbulluar forca të shumta për të goditur, dëmtuar e penguar Ushtrinë Antifashiste Nacionalçlirimtare në zhvillimin e forcimin e mëtejshëm të saj dhe luftën për çlirimin e vendit. Por hovi që kish marrë lufta, shtimi e forcimi i vazhdueshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare e thyen shpejt këtë përpjekje të dëshpëruar të armikut në shkallë vendi. Mbas kësaj, Ushtria Antifashiste Nacionalçlirimtare kaloi në mësymjen e përgjithshme, gjë që çoi në çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare luajti rol të rëndësishëm në Kosovë dhe në krahina të tjera të ish-Jugosllavisë. U zbatuan me vendosmëri detyrat e marra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇI, për të ndihmuar popullin e Kosovës për çlirimin e tij, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes të sa më shumë kosovarëve në këtë luftë të madhe, për të pasur të drejtën e vetëvendosjes pas mbarimit të saj. Po ashtu, u zbatua detyra për ngritjen e pushtetit, pasi shumicën në këshilla e kishin shqiptarët. Brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare dhanë një kontribut të veçantë në Kosovë. Në zbatim të detyrave të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, brigadat dhe formacionet tjera partizane të kësaj ushtrie u angazhuan për të penguar dhe dëmtuar forcat gjermane në tërheqje, me qëllim që ato të mos shkonin të organizuara në Frontin Perëndimor kundër Aleatëve. Në këtë aspekt, është e njohur lufta e dy divizioneve tona në ish-Jugosllavi, për të ndihmuar në çlirimin e popujve jugosllavë, divizione këto që vazhduan të pengonin e dëmtonin forcat gjermane që tërhiqeshin për në Frontin e Perëndimit, duke dhënë kontributin tonë në kuadrin e koalicionit botëror antifashist.

\*Marrë nga libri "Një shekull në memorie" i autorit Rr. Parllaku - Ish Kryetar i OBVL, gjeneral-lejtënant, Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit



## AKTUALITET

*Stërvitja që hap një rrugë të re entuziazmuere për një bashkëpunim më të madh strategjik.*

# “Defender Europe 2021”, stërvitja më e madhe e tri dekadave të fundit në Shqipëri

Stërvitja “Defender Europe 2021”, që u zhvillua në Shqipëri, prej 4 majit ishte më e madhja në tri dekadat e fundit. Me anë të kësaj stërvitje u demonstruan aftësitë ndërvepruese të Shteteve të Bashkuara me ushtritë partnere të NATO-s, për sigurinë në Ballkanin Perëndimor dhe rajonet e Detit të Zi. Kjo stërvitje u zhvillua njëkohësisht në 7 baza të ndryshme në të gjithë territorin shqiptar. Stërvitja u krye në bazat ushtarake të Bizës, Kuçovës, Pashaliman, Farkë, Rinas, Durrës dhe Zall-Herr. Stërvitja “Defender Europe 21” që u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit me palën amerikane ishte në vazhden e partneritetit të fortë strategjik që Shqipëria ka me SHBA-në, në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Komanda e Ushtrisë Amerikane në Europë (USAEUR) drejtoi paketën e stërvitjeve të koduar “Defender Europe 21” dhe pjesë e kësaj pakete ishte pjesëmarrja e forcave të vendeve aleate dhe partnere, si: Kanada, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Britania e Madhe, Çekia, Hungaria, Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Turqia etj.

## PËRMBYLLET ME DEMONSTRIME NË POLIGONIN E BIZËS, “IMMEDIATE RESPONSE 21”, PJESË E STËRVITJES “DEFENDER EUROPE ‘21”

Në përfundim të stërvitjes “Immediate Response 21”, pjesë e paketës së stërvitjes “Defender Europe 21”, efektivët të Batalionit II të Këmbësorisë kryen demonstrime të përbashkëta me efektivët komando, Forcat Speciale dhe efektivët të Forcës Ajrore. Ky aktivitet u mbajt në kuadër të “Ditës së Vëzhguesve”, në Poligonin kombëtar të Bizës dhe u ndoq nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, Komandanti i FT gjeneral brigade Arben Kingji, Komandantë Forcash, drejtorë të SHPPFA, si dhe Atashetë ushtarakë të vendeve anëtare të NATO-s, të akredituar në vendin tonë.



Gjatë fjalës së tij, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj vlerësoi përkushtimin e të gjitha këtyre forcave elitë të FA në përfundim të stërvitjes historike “Defender Europe 2021, duke shtuar se kjo nuk do të jetë e fundit.

Duke e cilësuar një mundësi të artë për Forcën Tokësore, angazhimin në “Defender 2021”, Komandanti i FT gjeneral brigade Arben Kingji u shpreh se: “Angazhimi jonë në këtë stërvitje së bashku me trupat e Brigadës 53-të amerikane u mundësoi efektivëve tanë të trajnohen me skenarë të vërtetë luftimesh duke praktikuar procedurat dhe manovrat që janë thelbësore për gadishmërinë dhe ndërveprueshmërinë tonë”.

Efektivët kryen në këtë stërvitje të përbashkët demonstrime të tilla si: goditje objekti nga toka dhe ajri, lirim pengu, aplinizëm, qitje me snajper, qitje me mortaja, veprimet e skuadrës në

sulm dhe pas rënies në pritë, dhënie e ndihmës së parë në fushë betejë si dhe evakuimin e të plagosurve.

## “DEFENDER EUROPE 21” NDALET NË TIRANË, MINISTRI NIKO PELESHI: TË RINJTË TË SHOHIN FA SI NJË MUNDËSI TË ARTË PËR KARRIERË

Pas turit në disa qytete, stërvitja “Defender Europe 21” është ndalur në Tiranë. Qytetarët patën mundësi të shohin nga afër, në sheshin “Nënë Tereza” helikopterët “Black Haëk”, mjetet e blinduara dhe demonstrime të ndryshme të efektivëve amerikanë e shqiptarë.

Pas ekzekutimit të dy himneve, atij shqiptar dhe amerikan, fjalën e hapjes e mori shefi i Përgjithshëm të Shtabit të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj.

Ai shprehu angazhimin e ushtarakëve shqiptarë për t’u gjendur

pranë qytetarëve në çdo situatë. Ai siguroi dhe aleatët e NATO se FA janë të gatshme të qëndrojnë krahas krahas me aleatët në çdo angazhim.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u bëri thirrje të rinjve që të shohin Forcat e Armatosura si një “mundësi të artë” për karrierë. Ministri Peleshi tha se “Defender 21” ka qenë mundësia më e madhe edhe për të testuar kapacitetet ushtarake të vendit tonë.

Ambasadorja amerikane Yuri Kim nënvizoi se marrëdhënia e Shqipërisë me SHBA do të jetë mbi çdo gjë. “Si miq dhe aleatë, ushtarët amerikanë dhe shqiptarë kanë qenë në krahas të njëri-tjetrit në konflikte të shumta, nga Kosova në Afganistan, në Irak dhe më gjerë. Dhe e dimë nga ato përvoja që Amerika ka një mike të vërtetë dhe të guximshme tek Shqipëria.

“Defender 21” hap një rrugë të re entuziazmuere për një bashkëpunim më të madh strategjik. Kjo rrugë do të shohë që ushtarët amerikanë do kthehen në Shqipëri për të stërvitur, për të ndërtuar partneritete dhe për të bërë miq për jetë. Unë besoj se suksesi i “Defender 21” pasqyron angazhimin e udhëheqësve dhe të popullit të Shqipërisë.” - u shpreh diplomatja Yuri Kim.

Teksa vlerësoi ushtarakët dhe përgëzoi ambasadorën e SHBA për kontributin dhe përkushtimin në forcimin e kapaciteteve në mbrojtje dhe në drejtësi, kryeministri Edi Rama deklaroi se misioni tjetër i përbashkët mes Shqipërisë dhe SHBA do të jetë rritja e kapaciteteve njerëzore të Forcave të Armatosura.

Presidenti Ilir Meta tha se operacionet e trupave shqiptare me ato amerikane kanë qenë të suksesshme dhe janë realizuar të gjithë objektivat.



FJALA

# SHBA dhe Shqipëria, krah për krah, përgjithmonë



Yuri Kim\*

(vijon nga fq. 1)

Ushtarët tanë në uniformë ndihen saktësisht sikurse ndihemi ne diplomatët, të veshur me kostume, për këtë vend: Ata mrekullohen me bukurinë e Shqipërisë, vlerësojnë mikpritjen e ngrohtë të popullit shqiptar dhe janë krenarë që Shtetet e Bashkuara e quajnë Shqipërinë një mik dhe Aleat. Si miq dhe aleatë, ushtarët amerikanë dhe shqiptarë kanë qenë në krah të njëri-tjetrit në konflikte të shumta, nga Kosova në Afganistan, në Irak dhe më gjerë. Dhe e dimë nga ato përvoja që Amerika ka një mike të vërtetë dhe të guximshme tek Shqipëria.

“Defender 21” hap një rrugë të re entuziazmuere për një bashkëpunim më të madh strategjik. Kjo rrugë do të shohë që ushtarët amerikanë do kthehen në Shqipëri për të stërvitur, për të ndërtuar partneritete dhe për të bërë miq për jetë. Unë besoj se sukcesi i “Defender 21” pasqyron angazhimin e udhëheqësve dhe të popullit të Shqipërisë.

Ne e vlerësojmë që pavarësisht nga dallimet që mund t'i ndajnë njerëzit kohë pas kohe, ju e pranoni që gjendemi në një moment të rëndësishëm në histori dhe të gjithë jeni të bashkuar në marrëveshjen tuaj me ne të gjithë, mbi vlerën dhe rëndësinë e një marrëdhënieje edhe më të fortë midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, midis amerikanëve dhe shqiptarëve.

“Defender 21” vjen ndërsa festojmë 30 vjetorin e përfundimit të diktaturës komuniste, fillimin e demokracisë në Shqipëri dhe rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. Vjen gjithashtu njëqind vite pasi Shtetet e Bashkuara qëndruan me ju në kërkesën tuaj të drejtë për një Shqipëri të pavarur. Ne qëndrojmë me ju sot, në mbështetje dhe solidaritet të fortë për një Shqipëri demokratike, të pavarur, të fortë.

Do të vazhdojmë të qëndrojmë me ju ndërsa ndërmerni detyrat e vështira, tashmë të nevojshme, për të arritur potencialin e plotë të Shqipërisë.

Këto detyra janë të vështira por nuk janë të pamundura. Edhe nëse do ishin të pamundura, nëse dikush mund të sfidojë vështirësitë, ai është populli

shqiptar. Ju e keni bërë këtë herë pas here përgjatë historisë, dhe më duhet të them se jam vërtetë e prekur që jam këtu, në Shqipëri, dhe të shoh drejt sheshit Skënderbej, statujën e heroit tuaj, i cili duhet të jetë një hero për të gjithë ne si një simbol i bashkimit, këmbënguljes dhe vizionit. Jam krenarë që jam sot këtu me ju, jemi krenarë që jemi me ju si aleatë këtu sot, nesër, krah për krah, përgjithmonë.

\* Fjala e Ambasadores Yuri Kim në Ditën e Hapur të Stërvitjes Ushtarake “Defender 2021”

**Blloku evropian, bashkë me popullin e Kosovës dhe atë të Serbisë, kanë pritshmëri të larta nga të dy liderët**

## Kurti: Serbia të njohë pavarësinë e Kosovës

• **“Ne duam një dialog të përgatitur mirë, ku të gjithë duhet të jemi të barabartë”, thotë Kurti duke shtuar se zgjidhja duhet të çojë në njohjen e reciproke mes këtyre dy vendeve**

Nuk ka qenë aspak i lehtë takimi i 15 qershorit 2021 mes Kryeministrit të Kosovës Albin Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar kështu i dërguarit i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajçak.

Ai ka deklaruar se procesi i dialogut do të vazhdojë para fundit të korrikut. “Të dy liderët patën një shkëmbin idesh në lidhje me atë që ata presin nga dialogu. Ajo çfarë ka rëndësi për BE, është e njëjtë si ajo që kanë konfirmuar edhe dy liderët se nuk ka formë tjetër për të ecur përpara përveç normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Ata do të punojnë në normalizimin e këtyre marrëdhënieve nëpërmjet dialogut”, deklaroi Lajçak pas takimit.

Sipas Lajçakut, blloku evropian, bashkë me popullin e Kosovës dhe atë të Serbisë, kanë pritshmëri të larta nga të dy liderët, që të tejkalojnë trashëgiminë e së kaluarës dhe të ecin përpara me dialogun mes Kosovës dhe Serbisë drejt të ardhmes evropiane.

Kryeministri i Kosovës, deklaroi se gjatë takimit ka prezantuar ide të reja dhe ka shprehur vullnetin

## Nga Shqipëria dhe Kosova, dy pilote ushtarake që bashkëojnë SHBA dhe Shqipërinë në “Defender 202

Valdete Mehanja dhe Armela Murati janë dy pilotet që duket i kanë dhënë kuptimin e vërtetë qëllimit të stërvitjes më të rëndësishme që zhvillohet në Evropë, “Defender 2021”, ndërveprimi mes aleatëve të NATO-s. Nëntoger Valdete Mehanja ka lindur në Kosovë, por prej vitesh ajo është pilote helikopteri me Regjimentin e Aviacionit 1-131, në Gardën Kombëtare të Alabamës. Ajo ka ardhur në Shqipëri si pjesë e trupave amerikane që po marrin pjesë në stërvitjen “Defender ‘21”. Në Bazën Ajrore të Farkës ajo është takuar me të vetmen vajzë të kursit të pilotit për helikopterët ushtarakë, nëntoger Armela Muratin. Armela i është bashkuar prej një viti Forcave të Armatosura shqiptare dhe thotë se ka zgjedhur rastësisht këtë kurs, pasi u emërua në Forcën Ajrore.

Të dyja vajzat kanë ndarë mes tyre sekretet e profesionit, por edhe kanë bashkuar ambicien për të qenë të barabarta mes burrash në këtë profesion.

Nëntoger Mehanja thotë se për të ishte befasia të vinte në Shqipëri si ushtarë amerikane, pasi nuk kishte qenë asnjëherë më parë. E pyetur përse kishte zgjedhur t'i bashkohej ushtrisë amerikane, ajo ka një arsye të fortë: “I jam bashkuar ushtrisë amerikane, sepse kjo ushtri, veçanërisht Amerika e ka ndihmuar shumë popullin shqiptar, sidomos Kosovën. Dhe e ndiej veten si në borxh”. Nëntoger Mehanja thotë se më herët ka qenë pilote civile.

Ndërsa nëntoger Armela Murati, tekta dëgjon nga kolegja amerikane këshillat në gjuhën shqipe, thotë se ka marrë mbështetje dhe kurajë në një mjedis ku mbizotërojnë burrat. “Nuk kisha synim të bëhesha pilote. Thjesht doja t'i shërbeja vendit tim, fati deshi që unë t'i bashkohen Forcës Ajrore dhe tashmë jam edhe kursante. Presioni është goxha i madh, por unë kam ardhur me synime të qarta dhe dua që këtë hap që kam hedhur ta çoj deri në fund”, - shprehet nëntoger Murati.

E këtë ambicie të vajzës së re nga Shqipëria e inkurajon nëntoger Valdete Mehanja, e cila ka kaluar 11 vjet për të arritur deri këtu. “Mos u dorëzo, se gjithçka ia vlen!”, - shprehet shqiptarja që përfaqëson SHBA në “Defender 2021”.

e tij në dialogun konstruktiv.

“Kosova dhe Serbia, duhet të nënshkruajnë një marrëveshje të përbashkët të paqes duke u zotuar se nuk do ta sulmojnë njëra-tjetrën. Pas njohjes së ndërsjelle midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në të dy vendet tona do të kemi reciprocitet bilateral, përfshirë edhe pakicat etnike, “tha Kurti.

Kurti ka thënë edhe se gjatë takimi ka ngritur edhe çështjen e personave të pagjetur, që sipas tij, është çështje “që nuk pret” dhe ka kërkuar të ndërmerren hetime për krerët e delegacionit serb në Kosovë, gjatë viteve të luftës.

Me tone më të ashpra u shpreh presidenti serbi, i cili deklaroi se palët kishin rënë dakord paraprakisht për pothuajse asgjë. Sipas tij, pala e Kosovës nuk dëshiron të plotësojë marrëveshjet që kanë nënshkruar. Gjatë këtij takimi, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, Josep Borrell ka deklaruar se dialogu dhe rezultati që del nga ai është rruga drejt të ardhmes evropiane të të dyja palëve.

Përveç Borrellit, takimi i parë ndërmjet Kurtit dhe Vuçiqit, u ndërmjetësua e edhe nga përfaqësuesi i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak.

Takimi i radhës mes Vuçiq dhe Kurtit në Bruksel do të mbahet para datës 25 Korrik kanë deklaruar dy liderët, megjithatë nuk është përcaktuar ende një datë specifike.

## HISTORIA

# MUNIR FIDA, EDHE NË KUSHTE TERRORI, U MËSOI NXËNËSVE HISTORINË E LAVDISHME TË SHQIPTARËVE

**Sakip Cami**

Mësuesi i mirënjohur, profesori i historisë në Gjimnazin e qytetit të Dibrës, Munir Fida, do të mbahet mend nga të gjitha gjeneratat, si profesori që u mësonte nxënësve të tij jashtë programit dhe në kushte terrori historinë e lavdishme të shqiptarëve që nga pellazgët, ilirët, arbërorët, shqiptarët e dikurshëm deri te shqiptarët e sotëm me shtrirje në pesë shtete. Për brezat mbarë ai u angazhua me mish e me shpirt për arsimimin dhe edukimin atdhetar shqiptar të brezit të ri në Dibër.

Profesor Munir Fida u lind në vitin 1932 në fshatin Kojnarë të Dibrës. Ai u rrit dhe u edukua në një familje të shquar atdhetare shqiptare. Daja i tij Feta Cami dhe gjyshi nga nëna Shaban Cami janë vranë në luftë me serbët në vitet 1916 dhe 1918. Ata janë shpallur dëshmorë të Atdheut.

Në fshatin e lindjes, në Kojnarë nisi shkollën fillore në vitin 1941 që me gjeneratën e parë me formimin e kësaj shkolle dhe përfundoi me suksese katër klasat e ciklit fillor. Nga klasa e pestë deri në të tetën i kreu në qytetin e Dibrës derinë vitin 1949. Pas mbarimit të shkollës 8 vjeçare kreu shkollën e mesme Normale "Zef Lush Marku" të Shkupit deri në vitin 1954.

Pas kryerjes së shërbimit ushtarak në vitin 1956 emërohet mësues në fshatin Bofmovë, ku ra në sy për punën e tij cilësore. Për këtë drejtori i shkollës së qytetit të Dibrës në vitin 1958, vetëm pas dy vjetësh e emëroi Munirin mësues në shkollën 8 vjeçare të qytetit ku shërbeu deri në vitin 1968.

Pas diplomimit si profesor historie që nga viti 1968 e deri sa del në pension shërben në shkollën e mesme të qytetit të Dibrës. Për katër vjet ka qenë edhe drejtor i internatit të këtij gjim-

nazi, ku ka ndihmuar qindra shqiptarë nga trojet shqiptare që të arsimoheshin në gjuhën shqipe.

Si profesor i historisë në një qytet shqiptar që ishte aneksuar padrejtësisht nga Maqedonia dhe R.F. Jugosllavisë, Munir Fida hasi në pengesa të mëdha dhe në përndjekje nga sistemi monist sllavo – komunist, i cili nuk dëshironte që shqiptarët të mësonin historinë e tyre.

Disa herë merret në pyetje nga policia maqedonase dhe ndaj tij aplikohet edhe dhunë psikike. (Sylejman Borova, "Pishtarët e diturisë 2"). Në një rast kur Muniri së bashku me të vëllain, Tosumin, kishin shkuar të punonin në tokën e motrës së tyre në fshatin Spas, edhe pse ishin larg vijës kufitare, mezi shpëtuan nga plumbat e ushtarëve të kufirit që i kishin survejuar vazhdimisht dhe kishin marrë urdhër t'i qëllonin e t'i egzekutonin.

Pas ngjarjeve të vitit 1981 në Kosovë, demonstratave të studentëve dhe minatorëve, në vitin 1984 filloi diferencimi edhe në Dibër. Komiteti sllavo- komunist tentoi dy herë që ta largonte nga puna si profesor i gjimnazit të qytetit. Megjithë këto ai nuk u përkul. Edhe pse historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve nuk ishte në programin mësimor, ai ua mëson të nxënësve të tij të gjitha gjeneratave historinë e ilirëve, të principatave të Arbrit, historinë e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, të kryengritjeve antiosmane, të Lidhjes shqiptare të Prizrenit, vargjet dhe këngët e bukura të rilindasve, heroizmin shqiptar në shekuj.

Profesor Munir Fida, me dashuri, përkushtim e pasion, me përgjegjësi e ndërgjegje të lartë kombëtare u mësoi të rinjve historinë e lavdishme të shqiptarëve.

Në vitin 1960, kur u hap gjimnazi për herë të parë së bashku me kolegët e tjerë Mahmud



Hysa, Bardhyl Cami, Irfan Uruçi etj punuan pa pagesë për më shumë se një vit, vetëm e vetëm që të shpallej regjistrimi dhe funksionimi i këtij institucioni jetik për qytetin e Dibrës,

Për 42 vjet më rradhë, Muniri shërbeu si mësues dhe paralelisht shërbeu edhe si historian. Pas vitit 1990 Muniri është zgjedhur kryetar i shoqatës së historianëve të Dibrës së madhe dhe në bashkëpunim me homologët e tyre të qytetit të Peshkopisë në vitin 1993 organizuan simpoziumin shkencor tre ditor "Dibra dhe etnokultura e saj". Deri në ditën kur u largua nga kjo jetë më 22 korrik të vitit 2004, ai mbeti i angazhuar fuqimisht për çështjen kombëtare shqiptare.

Muniri ka lënë një trashëgimi familjare të shkëlqyer.

I biri, Argëtim Fida, doktor i shkencave mjekësore, specialist obstetër gjinekolog, pedagog në Ush Tetovë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, ligjërues i lëndës "obstetrika" është zgjedhur kryetar i Komunës Dibër në dy mandate 2005-2009 dhe 2009-2013. Ai është pronar dhe menaxher kryesor i aktivitetit të klinikës private të gjinekologjisë dhe obstetrikës "Dr Fida" në Dibër të Madhe. Argetimi është martuar me Jumnije Marku -Fida, pedagoge e diplomuar, punësuar në shkollën fillore komunale "Penestia" në Dibër të Madhe, këshilltare pedagogjike për gjithë brezat e rij të arsimtarve në Diber. Argetimi dhe Jumnija kanë një djalë dhe një vajzë. Vajza e Munirit dhe Hatixhes, Dhurata (Fida) Bardoniqi, mbaroi fakultetin e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Prishtinës, u martua me Blerim Bardoniqin arkitekt i mirënjohur nga Gjakova. Ka qene gjithë kohes bashkëmenaxhere e kompanise ARKING (arkitekture dhe inxhinjering) në Gjakove dhe Prishtine. Kanë projektuar dhe ndërtuar shumë objekte të medha dhe prestigjioze në Kosove dhe Shqipëri. Blerimi eshte Martir i luftës së Kosovës .Dhurata dhe Blerimi kanë dy femije : Edonin dhe Rinën.

Djali tjetër, Arben Fida, ekonomist, gjatë gjithë jetes ka menaxhuar lokale hotelerike. Ai është zjarfikës profesionist. Gjatë tërmetit të nëntorit 2019, me thirrjen e shpirtit dhe të atdheut mëmë, Beni erdhi në Durrës dhe Thumanë dhe kontribuoi për nxjerrjen e trupave të dëmtuar nga gërmadhat. Aktualisht menaxhon restorantin ne pronesi familjare "PERLA" pranë plazhit të qytetit në Dibër. Eshtë i martuar me Engjellushe (Qoku) Fida, e cila punon në kopshtin e fëmijve Dibër si edukatore dhe që është shquar për kujdesin e theksuar për fëmijet.

Dëshira e profesor Munirit që gjimnazi i qytetit të Dibrës të ketë emërtimin gjimnazi "28 nëntori" tanimë është bërë realitet nga Këshilli komunal i Dibrës.




Shkolla e mesme "28 nëntori" Dibër

## 85 VJETORI

*Ka përgatitur e botuar mbi 100 artikuj me karakter shkencor në gazeta e revista*

# XHEMAL MEÇI, STUDIUESI QË NUK NJEH MOSHË!

- *Studjuesi Xhemal Meci, me një aktivitet 85 vite jetësore dhe mbi 65 vite eksperiencë pune ka spikatur në sektorë të ndryshëm si: arsimtar, zëvendës drejtor e drejtor shkollash e të kabinetit pedagogjik Pukë, sekretar i gjykatës Pukë, Përgjegjës i Muzeut Historik Pukë dhe me një veprimtari të dendur studimore -shkencore si dhe drejtues i Shoqatës së Historianëve të Pukës. Ai është mbajtës i mbi 65 kumtesave e referateve në sesione shkencore, simpoziume, konferenca e kongrese lokale, kombëtare e ndërkombëtare*



ik Pukë dhe me një veprimtari të dendur studimore shkencore si dhe drejtues i shoqatës së historianëve të Pukës. Ai është mbajtës i mbi 65 kumtesave e referateve në sesione shkencore, simpoziume, konferenca e kongrese lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Ka përgatitur e botuar mbi 100 artikuj me karakter shkencor në gazeta e revista. Puna, vepra dhe veprimtaria e tij studimore është vlerësuar me dëshmi e certiffika të shumta. Në këtë 85 vjetor i urojmë studiuesit Xhemal Meçi, jetë të gjatë dhe mbarësi në punën e tij studimore shkencore.

## JETËSHKRIM - XHEMAL MEÇI

Lindi me 23 korrik 1936, Kabashi i Pukës. Është autor i disa librave si:

*Puka që në Lashtësi; Poeti i Malësisë; Poeti i Kabashit; Kanuni i Lekë Dukagjinit varianti i Pukës; Kanuni i Lekë Dukagjinit varianti i Mirditës; Kabashi; Migjeni në Pukë me bashkë autor; Ndue Pjetri me bashkë autor; Komani, Ana e Drinit-Delmace trashigimi iliro-arbnore, etj.*

Për mbi 45 vjet ka qenë bashkëpunëtor i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë (Instituti Kulturës popullore, Instituti i Gjuhës e Letërsisë, Instituti i Historisë), si dhe bashkëpunëtor i Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër (sektori i Albanologjisë) por edhe bashkëpunëtor i Institutit të Albanologjisë në Prishtinë, Kosovë.

Për veprimtarinë e tij të gjithanshme studimor e shkencor ai ka marrë vlerësime të vazhdueshme nga lexuesi, nga personalitete të shkencës shqiptare, por dhe shtetërore si: Medalja "Naim Frashëri; Titull nderi "Mirënjohje e qytetit Pukë", Urdhëri "Naim Frashëri i Argjenditë", Urdhërin "Mjeshtër i Madh", Flamuri i Jubileut të 100-vjetorit të pavarësisë", Titullin "Qytetar Nderi" Bashkisë Pukë, etj.

Jeton në Pukë dhe megjithëse në një moshë 85-vjeçare vazhdon me një intensitet të lartë veprimtarinë e tij kërkimore, studimore e shkencore.



## Ing. Kol DEDAJ-Studiuues

Kohët që po kalojmë janë ndër më të vështirat që ka njohur globi gjatë shekullit të fundit, ku në mbarë njerëzimin ka pllakosur mbyllja dhe izolimi nga pandemia Covid-19, efektet e së cilës janë, papunësia, rënia ekonomike, kufizimet, izolimi, etj., duke ndikuar në jetën tonë të përditshme. Por, këto efekte nuk kanë ndikuar në punën dhe veprimtarinë hulumtuese të studiuesit Pukjan Xhemal Meçi ("Mjeshtër i Madh"), i cili me 23 korrik të këtij viti (2021) mbush plot 85 vjet.

Plot energji dhe pasion e fillon punën e tij të përditshme, me ndjekjen e shtypit periodik, e më tej pa vonuar është ndër telefonatat e para që marr prej tij i cili me elekuencën akademike më udhëzon: "Inxhinier Kola, merre këtë, apo atë gazetë pasi ka një arti-

kull të mirë e të veçantë për Pukën, apo për ngjarje të ndryshme të historisë sonë kombëtare". Dhe pasi me bën një kronologji duke e pasuruar edhe me njohuritë e tij shkencore ndahemi duke më kërkuar ndjesë, pasi më thotë se më duhet të vazhdoj me shfletimin e materialeve të shumta të grubulluara prej tij në vite e dekada, që të ngjan me atë minierën e arit, që sa më shumë gërmon aq më shumë del xeheror.

Në përditshmërinë e tij nuk rresht së prituri vizitorë në muzeun historik të Pukës duke iu shpjeguar atyre (vendas dhe të huaj), historinë dhe trashëgiminë kulturore e etnografike Pukjane. Por, paprimtas vjen darka dhe telefonata e rradhës pasi ndjehet shumë i lumtur të bëjë me dije se në arkivën e tij ka gjetur një material të cilin e ka eksploruar e grumbulluar mbi 50 vite me parë.

Në takimet e shpeshta e në çdo bashkëbisedim me studiuesin Xhemal Meçi, ka diçka për të mësuar prej tij. Ai, me durimin e modestinë që e karakterizon të shpjegon për çdo gjë që e pyet, madje me një mirësjellje tipike intelektuale me këshillon të mbaj edhe ndonjë shënim, duke më thënë: me pyet përsëri kur të ulesh për ti sistemuar. Ndërkohë në takimin që pata ditët e fundit, teksa iu drejtova me kureshtje duke i thënë "tani profesor mjaft më me këtë dinamikë të lartë", ai pa vonuar mu përgjigj: "Ky, ritëm i tanishëm është i ulët pasi mbyllja nga pandemia po më vështirëson vizitat në disa vende historike si në Berishë, Qerret, pasi duhet të shkruaj diçka për to, por ama kam në dorëshkrim dhe me patjetër duhet ta botoj së shpejti: 'Puka në luftë për liri e dëshmorët e saj' (Qyteti i Pukës dhe lagjet Fshat; Migjeni përëri në Pukë; Doke lidhur me blegtorinë dhe bujqësinë në Pukë; Malësia e Gjakovës (Tropoja) në vështrimin etnografik; Lura në veçoritë e hershme të saj etnokulturore., ndaj ritmi duhet rritur".

Studjuesi Xhemal Meci, me një aktivitet 85 vite jetësore dhe mbi 65 vite eksperiencë pune ka spikatur në sektorë të ndryshëm si, arsimtar, zëvendës/drejtor e drejtor shkollash e të kabinetit pedagogjik Pukë, sekretar i gjykatës Pukë, Përgjegjës i muzeut histor-



## DEKRETI

*Forcat e Armatosura krenohen me profilin e shefes së tyre, doktore e shkencave, gjeneral major dhe juriste*

# Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare me gradën madhore “gjeneral major”

- **Numri dy i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (nga data 16 janar 2018 e në vijim kryen detyrën e Zëvendëshefit të SHP të FA) vjen në këtë funksion mjaft të rëndësishëm pas një karriere të shkëlqyer në të gjitha nivelet e Ushtrisë Shqiptar**

## Nga Halil RAMA


Pesë vjet pasi mori gradën “Gjeneral brigade”, Manushaqe Shehu ngjitet në majën e hierarkisë ushtarake shqiptare. Me Dekretin Nr.1313, datë 17.06.2021, të Presidentit të Republikës, ajo bëhet e para grua shqiptare me gradën madhore “Gjeneral major”.

Afro pesë vjet më parë (16 nëntor 2016), Manushaqe Shehu hyri në histori si e para femër që do të shërbente si gjenerale në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Gradimi i gjeneral brigade Manushaqe Shehut u bë në një ceremoni të veçantë në mjediset e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Numri dy i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë (nga data 16 janar 2018 e në vijim kryen detyrën e Zëvendëshefit të SHP të FA) vjen në këtë funksion mjaft të rëndësishëm pas një karriere të shkëlqyer në të gjitha nivelet e Ushtrisë Shqiptare.

Veçanërisht gratë dhe vajzat oficere krenohen me profilin e shefes së tyre, doktore e shkencave, gjeneral major dhe juriste. Mbi të gjitha, tek ajo spikasin vlerat njerëzore. Personaliteti dhe karakteri i saj në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos me dinjitet për më shumë se tri dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri, ajo mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësuese e elitës intelektuale shqiptare. Si njohëse në mënyrë perfekte e dy gjuhëve të huaja (anglisht dhe italisht), dr. Manushaqe Shehu ka përfunduar kursin e CIMIC në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (mars-prill 2013), Kursin Gender Perspective in Peacekeeping Operations në Zagreb, Kroaci (qershor 2014); studimet për CIMIC&CIMI Oberamengau, Gjermani (shtator – tetor 2015); Kursin “Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore” në Qendrën P&P, Ankara, Turqi (maj 2016); Kursin e Leadershipit Strategjik, Budva, Mal i Zi (shtator 2016); Kursin e Sigurisë në “Qendra Marshall”, Garmish, Gjermani (korrik – shtator 2017) si dhe kursin “Building Integrity” në Mbretërinë e Bashkuar (tetor 2017). Në muajin gusht 2018, në mbrojtje të temës “Leadershipi dhe ndikimi i tij në menaxhimin e mjedisit të sigurisë. Rasti i Ballkanit e më gjerë”, fiton gradën shkencore “Doktor”. Ajo ka botuar një sërë artikujsh shkencorë dhe joshkencorë brenda e jashtë vendit, në revista ushtarake, në shtypin ushtarak e civil. Po ashtu ka marrë pjesë në disa aktivitete ushtarake ndërkombëtare në vendet anëtare të NATO-s dhe ato partnere të saj. Dhe jo vetëm kaq, si intelektuale bashkëkohore, demokracinë e konsideronte sfidë ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje.

Thelbi i mendimit dhe veprimit të saj ishte vetëm konkurrenca në vlera. Ajo besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen



nuk ka moshë, por mbetet e përgjeshme. E qetë, e pjekur, shumë e kulturuar, nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyes dhe autoritare në ndëshkimin e saj individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinjeritetit dhe dinjitetit.

Kuptohet, ajo ishte dhe është individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e saj mund t’i shërbenin dhe i shërbejnë shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm si drejtuese në disa nivele të Ushtrisë Shqiptare, deri në majën e piramidës së saj, si zëvendëshefe e SHP të FA të RSH-së.

Gjeneral major Manushaqe Shehu është titulluar oficere në vitin 1984 dhe në karrierën e saj të gjatë prej 37 vjetësh në uniformë ka shërbyer në disa detyra dhe funksione

## KUSH ËSHTË MANUSHAQE SHEHU

- U lind në Peshkopi më 5 nëntor të vitit 1965. Pas përfundimit të studimeve në Akademinë e Lartë të Oficerëve në Tiranë në vitin 1984 – 1988, emërohet Shefe e Logjistikës në Brigadën 3900, Peshkopi. Gjatë viteve 1989–1994, përfundon Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkodrës. Në vitin 1991 merr gradën Kapiten i Parë. Nga viti 1989 – 1996, kryen disa detyra të ndryshme në Logjistikë si itendente batalioni, shefe e shërbimeve të ndryshme logjistike për ushqimin, veshmbathjen, karburantin e kazerminin në brigadë, deri shefe e Logjistikës e Divizionit 1100, Shkodër. Në vitin 1996 emërohet Specialiste e Kontrollit Financiar dhe Rezervave të Paprekshme në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë detyrë e mban deri në mars të vitit 2000. Gjatë viteve 2000 – 2002 punon në ekipin amerikan të Departamentit të Mbrojtjes të SHBA, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si përkthyes, njëkohësisht kryen studime pasuniversitare (Kursin Themelor të Oficerit në SHPPFA dhe Kursin e Funksioneve) në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë.
- Në vitin 2003 merr gradën Major dhe emërohet Shefe e Shërbimit të Ushqimit në FA, detyrë që e mban deri në vitin 2004. Gjatë kësaj periudhe, ka qenë nismëtare e disa projekteve të ristrukturimit të FA dhe anëtare e Bordit të Kompanisë Amerikane SAIC “për ndryshimin e strukturave të FA”, si dhe anëtare e bordeve drejtuese të ndryshimit të disa rregulloreve të ndryshme për Logjistikën në FA. Drejtuese e Bordit të Ndryshimit të Normave të Ushqimit dhe Veshmbathjes e Kazermimit në FA. Në vitet 2004–2005 përfundon ADAMS P&P (shkollë logjistike) në Tur, Francë dhe Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm “Spiro Moisiu”, Tiranë. Në vitin 2006 merr gradën Nënkolonel dhe emërohet Shefe e Furnizimit të FA dhe në vitin 2007, Shefe e Protokollit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.
- **Më 8 tetor 2007** emërohet Ndihmëse e Presidentit të Republikës për Çështjet Ushtarake dhe Integrimin Euroatlantik. Gjatë kësaj periudhe përfundon studimet në Kolejin e Lartë Rajonal të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, Tiranë.
- **Në vitin 2010** përfundon Master Shkencor të Nivelit të Dytë (MND) në fushën e Sigurisë Kombëtare dhe merr gradën “Kolonel”.
- **Më 4 shkurt 2011** emërohet Këshilltare Ushtarake e Presidentit të Republikës.
- **Me 1 shtator 2012** emërohet Drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil – Ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes.
- Pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s,
- Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu ka qenë pjesëmarrëse në stërvitje të përbashkëta me vende anëtare të NATO-s, aktiviste dhe drejtuese e nismave në ndihmë të grave ushtarake e civile të FA dhe të rajonit. Gjatë karrierës së saj, ka qenë nismëtare e një sërë projektesh të përbashkëta civilo-ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare, ku një vend të veçantë zënë projektet për barazinë gjinore, për të cilat ka marrë mirënjohje dhe falënderime nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por edhe nga shoqëria civile e strukturat e tjera të kontrollit civil në Forcat e Armatosura.
- Më 1 nëntor 2016 emërohet Komandante e Akademisë së Nënoficerëve.
- Më 14 nëntor 2016 gradohet “Gjeneral Brigade”, e para ushtarake femër në historinë e Republikës së Shqipërisë që merr këtë gradë.
- Më 1 dhjetor 2016 emërohet në detyrën e Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.
- Gjeneral major Manushaqe Shehu është e martuar dhe ka dy fëmijë, një vajzë e një djalë.

## PROFIL

# BAJO KAZO – LUFTËTAR LABËRIE QË

*(Kushtuar luftëtarit shehit Bajo Kazo, (1820–1854), nga Fushëbardha e Gjirokastrës, i cili ka rënë për mbrojtjen e truallit shqiptar në Mecovë të Vilajetit të Janinës në luftën e parë më 1854, në përballje me junanët andartë. Për herë të parë pas 167 vjetësh të dhënat e trashëgimisë gojore, të këngëve dhe të dokumenteve vijnë në këtë shkrim në nderim të gjakut të derdhur për vendin, për trimin e mençur Bajo Kazo edhe në kuadrin e 201 vjetorit të lindjes)*



**Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI**

## FLAMURI ARBËROR I NGJYER ME GJAK DËSHMORËSH NËPËR SHEKUJ JEMI NË VENDIN TËNË, /QË PA LERË DIELL E HËNË!

Duke hulumtuar të djeshmen historike të luftëtarëve të Fushëbardhës dhe të mbarë Labërisë ndeshim në dy emrat e parë Bajo Kazo (i parë) dhe Habil Xhuvani, që ndoshta dhe pasardhësit e kanë të vështirë të specifikojnë plotësisht identitetet e tyre të para tetë brezash. Por brezat “përqafohen” dhe “shmallen”, i flasin njeri-tjetrit shqiptarçe në venat e gjakut, të gjuhës, të kulturës, të flamurit. Toka arbërore përcjell jehonën në breza së pari të kënduar e më tej të shkruar e treguar për mençurinë, trimërinë, heroizmin në luftë në mbrojtje të tokës sonë. Kënga, “jemi këtu në vendin tënë, /që pa lerë diell e hënë..”, u tregoi brezave rrugëtimin e gjatë historik, kultivimin nëpër shekuj të ndërgjegjes kombëtare e shoqërore, memorizimin e luftrave dhe gjakun e derdhur nëpër beteja. Burrat e shquar të Fushëbardhës dhe tetëqind shehitëve të tjerë që ranë në një betejë në Mecovë dhe rrethinat e saj të ish Vilajetit të Janinës, janë një copëz e flamurit arbëror të ngjyer shekujve me gjak dëshmorësh, që qëndron si roje lirie për t’u treguar brezave historinë e së vërtetës, të kombit të nëpërkëmbur, sulmuar e të lakmuar, duke hapur një çështje të munguar nëpër breza për dhënien e statusit “Dëshmor”, sepse mbi-jetesa në truallin arbëror ka ardhur vetëm përmes shpatës e jataganit, përmes gishtit në këmbëzën e pushkës në roje të truallit amanet të trashëguar nga të parët, historia ka ardhur përmes këngës. Është fakt se që prej luftrave antitanzimat, Luftës së parë për Vilajetin e Janinës më 1853-1854, betejave në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, betejave për Janinën dhe Shkodrën dhe për çdo copëz toke arbërore e deri më sot ka më shumë se 60 mijë të rënë në betejat e shqiptarëve për liri, pavarësi e demokraci. Në mes tyre qindra janë nga Labëria, por edhe dhjetra nga Fushëbardha, që me të drejtë është quajtur “Porta e parë e hyrjes në Labëri, porta e luftrave të pandërprera në këtë drejtim”. Skërfica ose Qafa e Erës së Jugut është një kala natyrore, që ka njohur miq dhe armiq. Pushtuesit gjithmonë e kanë lakmuar. Mijëra pushtues përfshi dhe “puishtuesit kalimtarë”, kanë “rregjistruar emrin”, si ushtarë, si udhëtarë, si miq dhe si armiq, kanë “shkuar” të vëzhguar, por dhe vjedhurazi e me djallëzi, kur i ka shembur burrëria dhe krenaria labe, i ka nënshtruar të ecin poshtë këmbëve të maleve hijerëndë e të pushtetshëm. Sa

herë binte briri i luftës banorët këtu shndroheshin në luftëtarë në istikamet e historisë, për të mbrojtur familjen, fshatin, krahinën, jetën! Në dekada e shekujt që shkuan nuk ka mugar guximi dhe kurajua për të luftuar dhe për të derdhur gjak për shqiptarizmin, për të mbrojtur lirinë, këtë plotfuqishmëri hyjnore të njerëzve të lirë, mosnënshtrimin ndaj pushtuesve dhe virtyt i jashtëzakonshëm i shqiptarëve.

### ERRËSIRA QË SOLLËN PUSHTIMET ME NDALIMIN E SHKOLLAVE SHQIPE

Treva e Labërisë sikurse dhe fshati Fushëbardhë për shekuj me radhë përjetuan ndalimin e shkollës, të dritës së diturisë dhe të rritjes së ndërgjegjes kombëtare. Edhe pse Bajo Kazo dhe bashkëmoshatarët e tij u rritën dhe burruan me traditë të mira të Labërisë. Drita e diturisë përhapet me kandilin e atdhetarizmit, që nuk u shua kurrë. Pushtimi osman i vendit i tronditi thellë pozitën e krishtërit edhe në Labëri. Ushtrimi i fesë vinte duke u bërë gjithnjë e më i vështirë si për klerikët e krishterë dhe për besimtarët. Gjatë fushatave osmane për shuarjen e kryengritjeve të shekujve XV–XVIII, bashkë me banesat e fshatarëve u rrënuan edhe vendet e kultit, u ndërrua besimi me dhunë në Labëri, por nuk u shua ndjenja e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarizmit. Shkatërimi i objekteve të kultit të besimit të krishterë dhe qëndrimi i fshatarëve për periudha të gjata maleve për t’u shpëtuar përndjekjes osmane, bënë çlirimin nga detyrimi për kryerjen dhe të atyre pak ceremonive fetare që më parë i respektonin në përshtatje me kushtet e vështira të jetesës. Qëndresa e krahinave malore e bëri Shqipërinë një plagë të hapur dhe një rrezik për Perandorinë dhe një nga mjetet për ta neutralizuar këtë rrezik që islamizimi. Por kundërvënja me forcë përpjekjeve të pushtuesit prapsjen e trysninë e islamizimit luajtën në këtë krahinë edhe pse murgjit bazilianë, shërbyen si misionarë të kishës së Romës për përhapjen e katolicizmit në Shqipëri. Ndërkohë që veprimtaria e tyre filloi që nga fundi i shek. XVI dhe vijoi deri aty nga gjysma e parë e shek. XVIII. Por misionarët, një pjesë e të cilëve ishin arbëreshë të Italisë, shërbyen në fshatrat e krahinës së Labërisë, veçanërisht në bregdet, jo vetëm si priftërinj, por dhe si mësues. Duke filluar që nga viti 1581, disa fshatra të krahinës, si Nivica, Zhulati, Shën-Vasili, Tërbaçi, Dukati etj., kanë pasur misionarë fetarë të Romës, që në fakt në vitin 1627 ata hapën një shkollë në Himarë, mësues i fundit i së cilës ishte Zef Skiroi, arbëresh nga Sicilia. Nga të dhënat dokumentare, pas bregdetit Himarës, Dhërmiut e Palasës, ku u hapën shkolla stacione, pati edhe një shkollë shëtitëse në brendësi të Labërisë, që kaloi edhe në Kardhiq, në Zhulat, Fushëbardhë dhe fshatrat e tjerë, por që nuk përmbushte urinë e trevës labe për shkolla. Prandaj edhe shkolla për Bajo Kazon si dhe për djemtë e vajzat e trevës ishte e ndaluar.

### \*PRIJËS LUFTARAK I ÇETËS SË FUSH- ËBARDHËS

Të dhënat biografike të Bajo Kazo (i parë), martir-it që ra për Vilajetin shqiptar të Janinës në pranverë të vitit 1854 në Mecovë, është transmetuar treguar e përcjellë si legjendë lufte brez pas brezi, është kënduar në këngë, jeton në tregimet e të moçmëve të Fushëbardhës, krahinës së Kardhiqit, Rrëzomës, mbarë Labërisë. Ai e donte shkollën, por koha ishte e mbrapshtë dhe shkolla ishte e ndaluar për shqiptarët. Dhe këtë e flasin faktet edhe pse në Labëri

shqipja jetonte e lirë, por statistikat europiane të kohës janë tmerruese. Këtu po sjellim një shembull statistike të tre dekadave pas rënies së dëshmorit të parë të Fushëbardhës Bajo Kazo. (sipas Serge Metais “Historia e shqiptarëve”, Paris, 2006), tabloja e shkollimit është e pabesueshme, pra tre dekada pas rënies në fushën e nderit të Bajo Kazos. Kështu në vitin 1887, Shqipëria kishte: 3000 shkolla, nga të cilat 1200 shkolla publike turko-osmane, 1200 shkolla private greke, 300 shkolla bullgare, serbe e vllahe, dhe vetëm 1 shkollë shqipe, që drejtohej nga Pandeli Sotiri! Çdo gjuhë lejohej të mësohej në “perandorinë tolerante”, të Babë Ali dovletit, përveç gjuhës shqipe! Katër vite më pas, Pandeli Sotiri eliminohet, shkolla shqipe mbyllet! Kjo është e vërteta, që shqiptarët duhet ta dinë, ndërkohë që bijtë e shqipes si Bajo Kazo ishin të etur për dije e kulturë, sepse zanatin e luftëtarit e kishin trashëguar nga të parët. Bajo Kazo ishte lindur në Fushëbardhë të Gjirokastrës, që për disa kohë ka qenë edhe në vartësi të nahijes së Delvinës, për shkak se zotërimet e fshatit Fushëbardhë kanë qenë këtej dhe matanë Qafës së Skërficës. Fisi “Kazo” shquhej si një ndër fiset me njerëz të pushkës, të punës, të trimërisë dhe urtësisë. Ai u rrit në një rreth familjar atdhetar, luftëtar e me tradita patriotike. Të parët e tij qenë ndeshur me vështirësitë e shumta të pushtimit, por dhe me rreptësinë e kanunore të kohës kur jetonin si familje e madhe në Shalë të Bajgores. Pas ardhjes në trevat “e ngrohta” shqiptare në zonën e Delvinës, që mendohet rreth vitit 1790-1800, vëllezëria e tyre u nda në tre fise “Kazo”, “Shalari”, “Shkurti”, por pati edhe mjaft humbje jetësh njerëzore si rezultat i sëmundjes së malarjes. Dëshmitë vijnë nga “Dëshmitarët e gojëdhënës” ose “arkivi” lëvizës i trashëgimisë, që e ka lënë “të shkruar” jetën si trashëgimi brezash e këngësh. Ndërgjegjia kombëtare i thirri në skenë bijtë e Labërisë 167 vjet më parë dhe ata ju përgjigjën duke vënë gjithçka në shërbim të atdheut, të tokës dhe nderit të të parëve. Vepra e prijësit luftarak të çetës së Fushëbardhës nuk kërkon dafina, sepse kush bie për atdhe mbetet përjetësisht i pavdekshëm.


### BIOGRAFI E BAJO KAZOS - HISTORI E SHKRUAR ME GJAK TRIMI NË KËNGË TRIMASH

Bajo Kazo lindi në Fushëbardhë të Gjirokastrës në pranverë të vitit 1820. Ishte koha kur vendlindja e tij sikurse gjithë treva e Labërisë e më gjerë vuante sundimin osman. Emrin ja vuri tradita, që e pasonte nga gjyshi tek nipi. E quajten “Bajo”. Nëna do t’i këndonte: “Rritu bir i nënës, /Të pret istikami, /Ngjishe jataganin, /Ta ndjekësh dushmanin..”. Kënga i mëkoi dashurinë për vendin, farefisnin, fshatin si dhe urrejtjen për armikun edhe pse fëmijëria e tij ishte e vështirë. Arsimiti ishte i pamundur si “mollë e ndaluar”. Arsimiti i përkiste vetëm fëmijëve të administratës civile e ushtarake osmane, që zhvillohej në mejtepet në osmanllisht. Bajua kur ishte fëmijë e mësoi gjuhën e nënës, të mëkuar me ndershmëri dhe trimëri, me sakrificë edhe osmanllisht. Ai u burrua para kohe si gjithë bashkëmoshatarët. Lëndinat e fshatit, kodrat dhe malet si kurorë u bënë dashuria e jetës, të jetës me blegtori dhe bujqësi ku ndihmonte familjen për të siguruar jetesën minimale. Në mbrëmje rreth vatrës ushqehet me tregimet e të parëve, me trimëritë dhe heroizmat, por dhe me fukarallëkun e kohës. Fryma dhe tradita atdhetare trashëgonte tek Bajua i ri betejat e të parëve në Shalën e Bajgores, por dhe të trevës ku ishin vendosur në Labëri, ku besën, trimërinë dhe zakonet e mira i trashëgonin shekujve. Kur hodhi shtat të lartë dhe trupin e kishte të lidhur si një thupër, por



## PROFIL

## GJAKUN E FALI PËR MËMËDHENË



Bajo Kazo  
(1820-1854)  
Deshmor i Atdheut, Fushëbardhë

mjaft të fuqishëm konsolidoi vetitë e një karakteri të fortë të duruar, me temperament të zhvilluar dhe djalë i hedhur, por që në vetvete kishte fituar veti të një luftëtari të papërkulur, besnik dhe trim dhe që besa ishte trashëgimia e shenjtë e çdo familjeje labe. Nuk mund t'i shpëtonte nizamëllëkut që kosharet osmanë mobilizonin çdo vit qindra e mijëra djelmosha të gjithë sanxhaqeve/ prefekturave dhe Vilajeteve shqiptare në gadishullin e Rumelisë. Pa mëdijshje ju përgjigj thirrjes dhe me qindra të tjerë u gjend në vaporrin "Daut" që nga brigjet e skelave shqiptare që mbushur me djem nizamë e që fillimisht i ndalën në kazermat e Stambollit. Prej andej i shpërndanë sipas destinacioneve të sulltanatit jo pak por për shtatë vjet. Fati e deshi t'i mbijetonte. Trimëria, durimi, mirësia dhe fisnikëria e shoqëroi që ta kapërcente jetën anadoliane dhe të sosej në Fushëbardhën e dashur, që edhe pse jetonte hallet e kohëpushtimit ishte e lirë sipas mënyrës së vet të të punuarit dhe të mbijetesës. Bashkëfshatarët dhe mbarë Labëria dinin që jetën ta mbronin me jetë. Shquheshin për kanunllinj fisnikë në rrugën që u'a kishin lënë trashëgim të parët. Në kujtesën e Bajos kishin ngelur dy kuvende të mëdhenj: Kuvendet e Besës në Senicë më 1770 dhe Kuvendi i Rrepeve të Agait më 1773 të organizuar ligjvënësi i madh popullor Idriz Sulli. Këto ngjarje ishin vetë jeta e njerëzve të rinj dhe të moçëm të Fushëbardhës. Përgatitja për luftë me jatagan e pushkë ishte zanati që trashëgohej brez pas brezi, ndërkohë që sulltanati e shfrytëzoi jo pak herë trimërinë e shqiptarëve për të mbrojtur tokat nën pushtim edhe pse ato vetë ishin toka shqiptare. Fushatat e lufrave rëndonin dhe mbi redifët e Labërisë. Fushëbardha brez pas brezi kishte rritur një brez djemsh të mençur e trima, që e ruanin si çmuar besën e kuvendeve dhe që në rastet kur çenohej trualli i të parëve jo si detyrim shteti, por si detyrim kanuni i vendosnin gjoksin rrezikut, për mbrojtjen e truallit arbëror. Bijtë që derdhnin gjakun u këndohej këngë trimash. Bajo Kazo dhe Habil Xhuvani dhe bashkëfshatarët të tjerë ju përgjigjën thirrjes si redif/rezervist në mbrojtje të truallit arbëror të vilajetit të Janinës nën thirrjen: "Vilayet tehlikede"/vilajeti në rrezik! Ndërgjegjja kombëtare ishte praktikisht në zbatim, sa herë fshatrave u kërkoheshin që të ngrinin çetën e gatshme për luftë, ndërkohë që për luftë shqiptarët ishin gjithmonë të gatshëm. Të tillë i kishte përgatitur historia. Me thirrjen që Mahmud pashë Vlora u bëri ridifëve në vjeshtë të vitit 1853, si viti i mobilizimit të rezervistëve nga Labëria. Bajo Kazo dhe Habil Xhuvani nga Fush-

ëbardha u nisën për luftë bashkë me luftëtarë të tjerë të fiseve Yzeiri, Bineri, Çarçani, Golemi, Velu, Onjea, Shalari, Shkurti, Kazo, Xhuvani, Poçi, Shehu, etj. Ishin rreth tridhjetë luftëtarë, burra e djem që "luftën ua hante syri" pjesëmarrës dy tabore/batalione me rreth një mijë e pesëqind luftëtarë redifë e vullnetarë. Djemtë e Labërisë ishin të shquar për luftë e qëndresë, një racë arbërore që luftën e kishin zanat, ndërkohë që gjakun nuk e kurrësinin kurrë për një çështje të drejtë. Eshtrat e dëshmorëve ishin barikada e lirisë dhe e tillë vlerësohej në breza. Gjaku i mbi tetëqind shqiptarëve që ranë në pranverën e vitit 1854, për Mecovën dhe rrethinat e saj, është gjaku i dëshmorëve që mbronin jetën përballë mercenarizmit junan, që kërkonin të zaptounin tokat, fshatrat, shtëpitë, dhe që merrnin nderin, dinjitetin dhe krenarinë. Mbijetesa e kombit tonë përballë çdo pabesie edhe pse ka kaluar më shumë se një shekull e gjysmë, historia dhe kombi i dokumenton dhe nuk harron gjakun e derdhur për truallin dhe kombin shqiptar. Burimet dokumentare dhe këngët bënë që historia të mbijetojë deri në ditët tona dhe të publikohet në kuadër të 201 vjetorit të lindjes së Bajo Kazos, së parë.

#### DJEMTË SHQIPTARË KUR SHKONIN "NIZAMË" DHE LUFTONIN PËR DOVLETIN

Fakt është se djemtë e Fushëbardhës i merrnin "nizamë", (rregull, rrend, ligj) dhe i çonin në Delvinë, dhe nga garnizoni i Delvinës ku grumbulloheshin djemtë që do bëheshin "asker" i çonin në skelën e Sarandës, ku vinte vaporri me emrin "Daut", që mbushej me djem shqiptarë për të bërë askerllikun shtatë vjeçar. E kishte edhe kjo "të mirën" e vet dhe kjo e mirë ishte arti më i vështirë në botë që ishte lufta si art shkatërrimi. Fakt është se nizamllëku i kishte mësuar dhe burruar, në kufijtë ekstremë të jetës, u kishte mësuar artin luftarak osman, përdorimin e armëve, kamës, thikës, pushkës që e kishin profesion të trashëguar në breza nga tradita luftarake liridashëse. Të parët e djemëve të Fushëbardhës kishin luftuar historikisht me pushtuesit, dhe me tradhëtarët e brendshëm. Gemia "Daut", ishte bërë një emër i njohur për skelat bregdetare shqiptare. Kjo anije çonte në kazermat ushtarake/askeri këshillasënda, të Portës së Lartë "ajkën e djalërisë" shqiptare, në zbatim të fermanëve famëkeqë, që Sulltanati mbushte radhët ushtarake për të mbajtur pushtetin e pushtimit me gjak, zjarr e hekur. Njerëzit në brigjet shqiptare e quanin pampori i zemrave të dhimbshurisë, të dhimjes dhe dashurisë, të mallëngjimit e shpresës, sepse ndër vendet ku shërbenin arnautët/shqiptarët ishte Anadoli e Jemeni sikurse çdo pikë e sulltanatit në tërësi miliona km<sup>2</sup> në tre kontinente. Jemeni njihej shumë prej këngëve popullore: "Ah more Jemeni,/trëndafil prej bari,/vallë kush shkon,/pse nuk kthehet më për së gjalli?". Porta e Lartë dhe Këshilli i Luftës. Në Arnavutlluk ishte "depozita" e djalërisë dhe e trimërisë njëherazi, ndërkohë që Vilajetet shqiptare që prej rënies së Gjergj Kastriotit Skënderbeut kishin rënë në "qetësi" ose në një farë mënyre ishin pajtuar me gjendjen. Por me shqiptarët e vërtetë nuk kishte kurrë pajtim. Popullin nuk e përfaqësonin një grusht njerëzish të administratës ushtarake dhe civile sepse shtypja për shqiptarët dhe mohimi i të drejtave vazhdoi gjatë. Acarimet dhe revoltat ishin të natyrshme sa herë tagarbledhësit dhe kosharet vinin për të vjelë taksat dhe për të kërkuar askerë. Bashkë bëheshin vetëm në kohë rreziku kur rrezikohej trualli i pushtimit ose toka e pushtuar, që në fakt ishte tokë shqiptare. Çështja shqiptare ka qenë gjithmonë e shenjtë, por luftat dhe të rënë në tokën tonë nuk rreshtën kurrë, si ushtarë, redifë, vullnetarë, por edhe si rebelë dhe kryengritës kundër çdo lloj pushtuesi. Ndërkohë që nizamllëku ishte kthyer në një farë mënyre si plaga më e rëndë e shoqërisë shqiptare, që nuk mjaftohej me kaq por edhe sa herë kishte lufta mbrojtja e truallit amëtar ishte detyrim brezash, detyrim që jo rrallë paguhej me gjak të djemurisë shqiptare

#### KËNGA QË LINDI NË LUFTËN E MECOVËS DHE U KËNDUA NË FUSHËBARDHË E LABËRI SËHIT, VATAN IÇIN DËSHMËS/ SHEHIT, RËNË PËR VATANIN

Dy bijtë e Fushëbardhës që luftuan dhe ranë trimërisht për Vilajetin e Janinës në Mecovë ishin Bajo Kazo 34 vjeçar, dhe Habil Xhuvani 30 vjeçar, në pranverën e 1854-tës, 167 vite më parë. Trupat nuk u sollën në vendlindjen në Fushëbardhë, por ngelën përjetësisht në Mecovë. Sollën vetëm "fermanin-mandatë", me një rresht të shkruar në osmanllisht: "shëhit, vatan için dëshmës/Shehit, rënë për vatanin". Megjithatë bashkëluftëtarët përpara se të vinte mandati sollën këngën për të rënë. Biografia më e mirë e të rënëve është shkruar me gjakun e tyre dhe është rregjistruar në kujtesën e popullit në fondin dokumentar: "arkivi-këngë e popullit". Trimat fushëbardhas që mbetën gjallë mbuluan shokët në Mecovë dhe sollën këngën që kapërcen shekujt dhe jeton dhe sot e kësaj dite si dëshmi trimëri e shkruar dhe e dokumentuar në piedestalin e lavdisë së shqiptarëve. Kënga u këndua brez pas brezi për birin e Fushëbardhës Bajo Kazo që ra heroikisht në rrethinat e Vilajetit të Janinës, në Mecovë dhe mbetën atje "ku i zuri balta", një praktikë e përhershme deri në fillim të shekullit të kaluar.

Ai mbeti memorial lirie, lapidar brezash, përjetësisht në memorien shqiptare në vargjet: "Mecova larë me gjak,/Luftojnë bijtë nën një bajrak,/Kashaisën Rumelinë,/Dy tabor të Labërisë,/jatagan, pisqoll, martinë,/Bëjnë harb(luftë) me junanë,/Flakë e ndezën vatanë,/U vranë ca trima të rrallë,/ Labëri çoi bërë lotë,/I derdha për ca luanë,/Që dhe hakun nuk ua dhanë,/Do bisedoj me sulltanë,/Për Bajon dhe për Xhuvanë...". Këngë e një poeti popullor që vetë tretet në shekuj por kënga jeton thotë: "Në Fushëbardhë dy nishanë,/ Bënë harb me junanë,/E dhanë xhanin për vatanë,/Habili me Bajo Kazë,/...". Është kënga e trimërisë që mbriti në Fushëbardhë nga xhephanja e frontbetejës, ende pa përfunduar lufta, kënga që jetoi dhe jeton gjatë për të shkruar në kujtesën historike të kombit trimëritë shqiptare, trimëri që janë shkruar me gjakun e derdhur për këtë truall nëpër shekuj. Kjo është kënga që lindi në xhephane luftime, u dokumentua dhe u shkrua në "arkivin-këngë" të historisë dhe u këndua në gjithë Labërinë. Prandaj ka marrë me vete pavdekësinë, meriton nderim në altarin e burrave të kombit. Është pikërisht kjo këngë që më së shumti u këndua në Fushëbardhë, por edhe në gjithë Labërinë. Bajo Kazo e derdhi gjakun për truallin shqiptar dhe meriton nderimin e respektin e brezave sikurse e meriton çdo luftëtar që gjakun e derdhi për Mëmëdhenë. Ky ishte "fati" i shqiptarëve deri në shpalljen e mëvetësisë, duke dhënë jetën për shërbim të Perandorisë, në mbrojtje të Arbërisë. Djemtë e Fushëbardhës dhe të të gjithë Labërisë që shkonin në roje të Vilajetit të Janinës, në Mecovë dhe në të gjithë Çamërinë shkonin të luftonin me bindje të plotë në mbrojtje të së drejtës së tyre kombëtare, në mbrojtje të familjes, fshatit, krahinës, gjuhës, kulturës e territorit shqiptar.

Djelmoshat shqiptarë që pavarësisht uniformës, formacioneve ku bënin pjesë, armatimit dhe kundërshtarit përballë kishin ideal Shqipërinë e lirë, truallin e tyre amëtar të trashëguar amanet në breza. Ata u bënë barikadë gjaku në portat e shqiptarizmit dhe derdhnin gjak për për vilajetin duke përfaqësuar luftëtarët kaonë në portat e Mecovës. Piedestali dhe panteoni i kombit shqiptar është mbrojtur e çimentuar me gjakun e të rënëve, me gjakun e shqiptarëve që kanë shkruar epope trimërie e guximi, që nuk mund të harrohen. Për këtë arsye luftëtarit dëshmor Bajo Arif Kazo bazuar në Ligjin nr. 109/2018, datë 20.12.2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", neni 5 "Kriteret për shpalljen e statusit "Dëshmor i Atdheut"; i takon akordimi i dhënies së statusit "Dëshmor i Atdheut", sepse kështu do të nderohet vepra dhe gjaku i tij, gjaku i tetëqind të rënëve në një betejë, i bijëve të shqiptarëve dhe mbi të gjitha do të nderohet dhe respektohet e vërteta.

## PROFIL

Në jetën shoqërore është promotor i organizimit dhe zhvillimit të mjaft veprimtarive

# Shpendi Topollaj, një jetë duke shkruar...

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

## ROMANI QË BËN APËL PËR PAJTIM

Shpendi Hulsi Topollaj ka dalë para lexuesit me romanin "Pajtimi", një vepër pranë realitetit të sotëm në Shqipëri. Romani na vjen në një kohë kur pas një periudhe tridhjetëvjeçare ende vazhdon përplasja klasore mes forcave politike. Në këtë vepër shfaqet ajo shtresë shoqërore që vuajt në sistemin e kaluar. Vet romani "Pajtimi" është një apel për kohën që jetojmë. Autori, gjatë gjithë trajtimit të subjektit bën thirrje për këtë domosdoshmëri shoqërore dhe politike. Ai shtjellon përmes një subjekti i cili rrjedh natyrshëm, ngjarje në detaje dhe në fun apeli tij për ta lënë pas të kaluarën, por të mos e harrojmë, për integrimin e vendit në familjen europiane. Autori e ka ndërthurur këtë mision në veprën e tij nëpërmjet të besuarve të mendimit intelektual, të cilët ishin të dy pjesëmarrës në të kaluarën e përbashkët. Personazhet kryesorë me qendrim dhe bindje të ndryshme politike, përsëri bashkëjetojnë në të sotmen. Në roman ka ndodhira dhe degëzime, fenomene, ngjarje dhe personazhe. Boshti i romanit ndërtohet nga veprimtaria e dy personazheve kryesore, Jakov S dhe Bedri B; të dy këta personazhe janë njerëz të letrave, por kanë qëndrime të ndryshme. Jakov S ndikoi në burgosjen e Bedri B. Ky pas burgut dhe përmbyesjes së regjimit, nuk ngurron të botojë shkrime ndaj Jakov S.

Për t'i dhënë fund luftës që dy personazhet kanë bërë për vite me radhë, Shpend Topollaj jep në roman çelësin në një rrethanë njerëzore. Nga një ftohtësi midis dy personazheve, na vjen një ngrohtësi dhe lirizmi, pasi vjen një kohë dashurie midis djalit të Jakov S dhe vajzës së Bedri B. Dashurinë mes dy të rinjve, autori e ka përshkruar bukur dhe i ka dhënë ftohtësisë, dashuri dhe e përkrah dashurinë e tyre si simbol të bashkimit dhe të pajtimit.

Kjo dashuri mes të rinjve, pa u ndikuar nga e kaluara e prindëve të tyre, na jep një të ardhme për një angazhim të përbashkët. Kështu dy të rinjtë dalin si garant për unitet, larg bindjeve politike.


Autori në roman shtjellon edhe linja të tjera nga realiteti ynë aktual. Në roman trajtohen probleme aktuale si korrupsioni, i cili shfaqet përmes ndërimit të një hoteli me para të pista, përfshirjen e deputeti N, fenomene si matrapazllëku dhe manipulimet etj.

Autori trajton edhe fenomenin e garancisë për të ardhmen dy familjeve. Kështu, për të qenë të siguruar në çdo qeverisje, dy vëllezër bëhen anëtar partie kundërshtarë njëri me tjetrin. Sh.Topollaj përmes takimeve të ndryshme, bisedave dhe dialogjeve të shpeshta, nuk ka nguruar të shprehet hapur për shumë probleme të kohës, por dhe të tërheqë vëmendjen për të mos u përsëritur dukurit negative të regjimit të kaluar.

Në roman autori ka përshkruar mjaft skena që të ngelen gjatë në mendje, si vepri i kryetarit të degës së brendshme, përpjekjet për të rekrutuar mësuesin Hajdar Sh, tortura në burgje, dëbimi dhe internimi i familjes së Kristaqit etj. Autori ka ditur që me mjeshtëri të ngrihet në lartësinë e gjykimit dhe me këta njerëz, që provuan dhunën në diktaturë, të gjejnë forca për të falur, për t'i çuar brejt bashkimit dhe aktit të madh të pajtimit. Ky është një apel që përshkruan tërë romanin e shkrimtarit Shpend Topollaj.

## NJOHJA ME SHPENDI HULËSI TOPOLLAJ

Shpendi Hulsi Topollaj ka lindur më 14 shkurt 1947 në Berat. Babaj i tij, Hulësiu, ka qenë partizan nga të parët, e më pas oficer, jurist dhe shkrimtar.



Ai ishte nga Novosela e Kolonjës, kurse nëna, Hatijeja, ishte nga fisi i dëgjuar për atdhetari i Agallinjve në Vlorë. Përmijërinë dhe rininë e ka kaluar në Shkodër dhe Tiranë. Me përfundimin e shkollës 7-vjeçare "Misto Mame", në Tiranë nis studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej", të cilën e mbaron në vitin 1964. Me tej vazhdon Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1966 titullohet oficer këmbësorie. Emërohet në repartet ushtarake të Durrësit, ku ka kryer detyra të ndryshme, instruktor i stërvitjes me universitarë, shef i stërvitjes në Brigadën e Katërt të Mbrojtjes Bregdetare, komandant batalioni etj.

Kur babai u godit si bashkëpunëtor i "grupit puçist", me argumentin se kishte shkruar 10 vjet më parë një libër për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, dhe ku midis të tjerave lartësonte figurën e Heroit të Popullit, Petrit Dume dhe të tjerë të luftës nga Kolonja, ulet në detyrë të ulët, dhe punon në një repart ushtarak të largët, ku qëndron për rreth njëzet vjet. Por, Shpendi me formimin i tij intelektual, me edukatën e marrë nga familja dhe me përkushtimin në detyrë, shquhet për rezultate shumë të larta. Në punën e tij ai ka shfaqur talent, kulturë, guxim, ndershëri dhe shpirt krijues duke realizuar të gjitha detyrat ushtarake. Në gjithë veprimtarinë dhe punën e tij ka gëzuar respektin e shokëve dhe vartësve, oficerë dhe ushtarë. Në këtë kohë i jepet grada ushtarake në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike. Ai studion me pasion, artin ushtarak, fushën e letërsisë, artit dhe të historisë etj. Me gjithë vështirësitë, Shpendi Topollaj ishte nga kuadrot e parë të ushtrisë që mbeshteti proceset demokratike në vend, duke shfaqur kurdoherë mirëkuptim. Në këtë kohë i jepet grada ushtarake nënkolonel dhe caktohet me punë shef i Mbrojtjes Civile të rrethit të Durrësit. Me përfundimin e karrierës ushtarake, caktohet në detyrën e Shefit të Seksionit të Mbrojtjes Shoqërore në Këshillin e rrethit të Durrësit.

## PROMOTOR I ORGANIZIMIT TË VEPRIMTARIVE

Në jetën shoqërore ai bëhet promotor i organizimit dhe zhvillimit të mjaft veprim-

tarive, kushtuar figurave të shquara dhe promovues i krijimtarisë letrare të autorëve të ndryshëm durrsakë. Këto veprimtari kanë qenë mbresëlënëse dhe kanë gjetur pasqyrim në stacionet televizive, në radio dhe gazeta. Me tej ai punon në Gjykatën e Rrethit, si jurist për 7 vite me radhë, si dhe për 12 vite ka kryer detyrën e Përmbaruesit gjyqësor, ku dhe doli në pension. Gjatë tërë veprimtarisë së tij ka kryer detyra shoqërore, si anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Durrës, nënkryetar i Shoqatës Kombëtare "Skënderbegasi", kryetar i degës së kësaj shoqate në Durrës, anëtar i Kryesisë së shoqatës të miqësisë Shqipëri - Rusi, nënkryetar i degës së SHKUR-it, sekretar i shoqatës të Intelektualëve në Durrës, anëtar i Këshillit Kombëtar të OBVL, nënkryetar i Shoqatës Kolonja, dega Durrës etj. kohët e fundit është zgjedhur kryetar i Bordit drejtues të teatrit "A. Moisiu", është shpallur "Ambasador për Paqen", i është dhënë titulli "Noble Peace Personality Aëard" nga Eorlnd Parliament For Peace dhe njëkohësisht është zgjedhur nënkryetar i Federatës së Paqes Universale, dega Durrës.

Pas viteve '90 të shek. XX fillon të shkruaj dhe të botojë krijimtari të mirëfilltë letrare, thujse në të gjitha zhanret e letërsisë, si poezi, tregime, novela, romane, publicistikë, kritike letrare, drama etj., dhe mjaft artikuj të shkruar e botuar në shtypin e kohës. Disa nga librat dhe krijimet e tij janë përkthyer në gjuhë të huaja dhe botuar jashtë vendit duke u vlerësuar nga kritika e specializuar dhe lexuesit. Në nëntor 2015 nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Rusisë është dhënë çmimi "Pushkin" me motivacionin "Për bukurinë e fjalës dhe të mendimit".

Ndërsa për krijimtarinë e tij, jane botuar librat "Të shkruash në liri - Shpendi Topollaj: poeti, prozatori, kritiku, njeriu", "Liria e të shkruarit" dhe "Kur bashkohet mendja me zemrën". Nga mjaft studiues është vlerësuar për cilësitë e tij të rralla artistike, tematikën e zgjedhur dhe mesazhet që përcjell, nga pena të njohura. Në libri "Ishte koha kur...", kritiku Kostaq Xoxa ka shkruar: "Autor i palodhur dhe i talentuar i letrave shqipe të kohës së pasdiktaturës, Shpendi Topollaj, të befason

me prodhimtarinë e tij aq të shumëllojshme në gjinitë letrare më të larmishme: në poezi, në tregime, në novelat, dhe në romanet e tij; në kritikën letrare, në zbulimin, e thesareve të lashtësisë dhe veçanërisht të mitologjisë greke; në reportazhin artistik, në pasqyrimin dhe portretizimin e figurave të nëpërkëmbura nga një sistem totalitar gjysmëshekullor...".

## NË VEPRË KA FRYMË NJERËZORE

Krijimtaria e tij është e gjithanshme, ka vëllime me tregime e novela, libra me poezi, romane, përmbledhje me kritika letrare, monografi, artikuj të panumërt nëpër faqet e shypit etj. Ka botuar këto libra: "Lirikat e zemrës", poezi, përkthyer në italisht (1996); "Gjithë dashuritë e mia", poezi (1996); "Akropol për të gjithë", poezi, përkthyer në greqisht (2000); "Mjaft u grindën Perënditë", poezi (2001); "Tekat e Perendive", poezi (2004); "Magjistari i dashurisë", poezi (2004); "Kumtë nga Olimpi", poezi (2009); "Ishte koha kur...", poezi epigramik (2011); "Metaforë malli", poezi me bashkëautorë (2013); "Perla më e bukur", poezi (2014); "Ironia e moshës", poezi të zgjedhura (2015); "Rrëfimi i Kapitenit", tregime, përkthyer në frëngjisht (1998); "Një njeri i çuditshëm", tregime (2007); "Fisniku dhe horri", tregime dhe novela (2008); "Autografi", tregime (2011); "Arratisja", tregime (2011); "Amaneti", tregime, përkthyer në rumanisht (2014); "Adulteri", tregime (2012); "Allamanet", novelë, (përkthyer në italisht dhe gjermanisht (2008); "Pushkatimi", novele, përkthyer në italisht dhe rusisht (2008); "Ahu në mes të pyllit", tregime e novela të zgjedhura (2015); "Mobilitet e vjetra", tregime, përkthyer në rusisht (2019); "Kurva", novele, përkthyer në rusisht (2012); "Lotët e zambakut", roman, përkthyer në rusisht (1998); "Mashtruesi", roman (2006); "Mallkimi", roman (2010); "Luani i kafazit", roman (2011); "Zhgënjimi i partizanit të Gramozit", roman (2011); "Unë kam qenë në Mat'haugen", roman (2013); "Biri i Golemit, Adem Meta", roman (2015); "Jetoj në kujtimet tuaja", monografi (2016); "Romancë me letra dashurie", roman (2018); "Pajtimi", roman (2021); "E përdala", dramë (2020); "Ata ishin njerëz", dramë (2020); "Flakët e fjalës", kritika letrare (1998); "Jemi vëllezër", kritika letrare (2000); "Shoku më i mirë", kritika letrare (2002); "Paqja-virtyt i civilizimit", kritika letrare (2003); "Triumfi i arsyes", kritika letrare (2004); "Porta e dijes", kritika letrare (2007); "Vepra dhe vlera", kritika letrare (2008); "Armiq pa dashje", kritika letrare (2009); "Vagoni i mallrave", kritika letrare (2011); "Homazh librave", kritika letrare (2012); "Libri si Papirus", kritika letrare (2013); "Kur qesh dhe qan Kadare", kritika letrare (2013); "Vargmali i letrave", kritika letrare (2014); "Stile dhe lapsa", kritika letrare (2014); "Po thahet shpirti", kritika letrare (2016); "Shkolla ime "Skënderbej", kritika letrare (2017); "Urat e librave", kritika letrare (2017); "Purgatori i librave", kritika letrare (2018); "Flas për ju", kritika letrare (2019); "Jehona e librave", kritika letrare (2019); "Esse rreth shprehjeve mitologjike", (2019); "Dantja... e të tjerë", kritika letrare (2020); "Shejtoret e letrave", kritika letrare (2020); "Alternativa e kritikës", kritika letrare (2020); "Pesha e dinjitetit", kritika letrare (2020) dhe "Pranë jush", kritika letrare (2021).

Talenti i tij ka spikatur në çdo libër, në çdo gini duke e bërë atë tanimë një nga autorët tanë më të njohur dhe të dashur për lexuesit shqiptarë dhe me gjërë, sepse shumë prej tyre janë përkthyer dhe në disa gjuhë të huaja. Të shumtë janë autorët dhe krijuesit që ndjejnë mirënjohje dhe ndaj kritikut letrar Shpendi Topollaj, krijimtaria e të cilëve është e përfshirë në analizat dhe kritikave letrare të tij në shumë përmbledhje, ku shquhet objektiviteti dhe dashamirësia për veprat e kolegëve të tij.

## LIBRI

Një rrëfim historik i autorit Sakip Cami për luftërat, eksodet dhe epidemitë e viteve 1912 – 1920

# “Mos ma prekni lumin tim”

Ahmet Prenci, recensent i librit

Kur publicisti dhe studiuesi Sakip Cami ma besoi recensën e librit të tij “Mos ma prekni lumin tim”, unë e lexova me shumë ëndje dorëshkrimin. Gjatë leximit mendja u arratis në udhëtimin e atyre viteve, 100 vite më parë dhe, kuptova se si disa ngjarje të historisë përsëriten, për fajin e shoqërisë, ose jo të saj. Autori është ndodhur historikisht në buzë të lumit të Drinit të Zi. Ai është i lidhur pazgjidhshmërisht me historitë dhe kujtimet e këtij lumi. Që në titull ai ngre zërin ashtu si gjyshërit tanë që u ngritën dhe morën armët kundër Serbisë që donte të na pushonte tokën tonë dhe të na grabiste lumin tonë. Ky lumë dhe kjo tokë është vetë historia dhe jeta jonë. Njëpërmjet një rrëfimi herë popullor, herë letrar e historik, autori në këtë libër ka përshkruar luftërat e popullit dibran dhe atij shqiptar kundër serbëve dhe të gjithë pushtuesve, luftën e parë ballkanike, luftën e dytë ballkanike, luftën e parë botërore, luftën e vitit 1920, luftë e gërshetuar me epidemitë dhe pandeminë botërore 1918 – 1920 si dhe me eksodet më të tmershme të dibranëve të qytetit të Dibrës së madhe drejt Tiranës, Elbasanit e Durrësit. Ky rrëfim shtrihet në shtratin e një romani historik. Personazh kryesor në këtë vepër është populli me qëndresën e tij. Brenda këtij personazhi lartojnë majat e maleve dhe prijësit e krahinave të Dibrës, Lumës, Steblevës dhe më tej të Koplikut, Vlorës, etj.

Ishin jo pak, por nandë vjet luftë me kraljët pushtues 1912 – 1921 derisa më në fund pushtuesit u zbrapsën matanë kufirit të vitit 1913. Lidhja e Kombeve pranoi Shqipërinë anëtare të saj. Në këto nandë vjet nuk mjaftoi vetëm pushtuesi, por u shfaq edhe flama, një flamë vrastare që në nivel botëror vrau miliona njerëz, edhe më shumë se lufta e parë botërore. Kur armiqtë e Shqipërisë nuk arritën ta mposhtnin popullin e Dibrës së madhe, e detyruan me forcë atë që të linte trojet në vitet 1913 dhe 1920 e të largohej, por përsëri nuk e mposhtën. Dibranët mbijetuan në Dibër dhe mbijetuan në Tiranë, bile edhe më të fortë dhe më vitalë.

Libri fillon me ngjarjet e nëntorit 1912, kur në Vlorë shpallej pavarësia ndërsa Dibrën e sulmoi Serbia. Dibra i kreu me suksese të dy detyrat ndaj atdheut; përcolli delegatët për në Vlorë dhe u vu përballë pushtuesit serb, duke mos e lejuar atë të merrte territore.

Na paraqitet mjaft interesante në libër, pritja nga dibranët e Mehmet Dërrallës dhe Isa Boletinit. Shoqërimi i tyre ishte një traditë e spikatur, një protokoll unikal, që për nga ana ushtarake do ta kishte zili çdo ushtri e polici dhe, për nga mikpritja e jashtëzakonshme njihet gjërësisht veçantia e Dibrës. Përshkrimet për lumin e Drinit të Zi dhe të qytetit të Dibrës janë përshkrime që do i admironte çdo kineast që do të dëshironte të bënte një film



epik të këtyre ngjarjeve.

Lufta në Lumë dhe në Dibër, na paraqitet e pandarë në libër, ashtu siç ka ndodhur në të vërtetë ku lumjanë e dibranë me heroizmin e vet epik kanë përballuar së bashku betejat heroike në mbrojtje të vatanit. Po kështu një vënd të veçantë në këtë vepër që vend lufta e Grykës së Vogël që ndodhi në dhjetor 1912 – janar 1913, zgjati 19 ditë dhe 19 netë dhe na jepet e përshkruar deri në detaje. Me shumë rëndësi historike është lufta që dibranët zhvilluan në ndihmë të Shkodrës në luftë me Malin e Zi. Gjashtë muaj luftime të viteve 1912 – 1913, na paraqitet një tjetër epike e lavdishme që autori, i mbështetur në gjurmimet historike dhe kumtin popullor e ka përshkruar në mënyrë të hollësishme. Eksodi i viteve 1912 – 1913 i banorëve të qytetit të Dibrës së Madhe u shoqërua me dhunë masive nga serbët që pothuajse e brazën të gjithë qytetin. Kjo në këtë libër paraqitet me hollësi si një kronikë tragjike që shkrimtari Haki Stërmilli në shënimet e tij e ka përshkruar qytetin si një thertore njerëzish.

Libri trajton edhe tema të tjera si

lufta për pushtet, vizitën e Esat Pashë Toptanit në Dibër në vitin 1914 dhe përcjelljen e tij andej nga kishte ardhur. Esati kërkonte ndihmë për të ardhur në pushtet, ndërsa populli i Dibrës përballë me zinë e bukës. Viti 1915 përmbledh shumë vrasje politike të drejtuesve të luftës së popullit dibran si atë të Hoxhë Moglicës, që u varros për së gjalli duke thënë: “Në këtë vend ku unë po bi/ ka qenë, asht dhe do të jetë Shqipni.” Vrasja e Mersim Demës, që njihej si mbreti i maleve edhe nga Princ Vidi, ishte një tjetër vrasje misterioze e kohës. Vrasja nga serbët e Elez Koçit, prijësit të Gollobordës sepse nuk u bindej atyre dhe mbronte tokën amtare ishte një tjetër ngjarje që tronditi lëvizjen atdhetare të kohës. Po në vitin 1915 vritet në pabesi Hoxhë Hazis Efendi Lila nga Stebleva, delegat i Kongresit të Manastirit dhe të Dibrës, i shkolluar në Francë, që kishte si devizë: “ta bëjmë popullin tonë më të pasur dhe më të lumtur njëllëj si kombet e qytetëruara” duke e dëshiruar atë si Franca ku edhe studoi.

Që të gjithë myslimanë e të

krishterë, përpara se të jemi të tillë, jemi shqiptarë, deklaronte ortodoksi nga Klenja e Gollobordës Vasil Pleushku dhe transportonte abetaret që sillte nga Stambolli e Bukureshti Hazis Lila e Hasan Moglica. Sapo e diktuan serbo – bullgarët e vranë dhe ja zhdukën kufomën. Libri është i ndarë edhe me ngjarje edhe me vitet e zhvillimit të tyre. Në vitin 1916 trajtohet lufta me bullgarët gjatë luftës së parë botërore si dhe lufta me kolerën. Në vitin 1917 austro – hungarezët apo nemcet siç i quante populli u përfshinë edhe ato në raprezalje të popullsisë saqë populli ka lënë shprehjen: “koha e nemces, mos ardhte kurrë”

Viti 1918 është viti i mbarimit të luftës së parë botërore. Ato që la pa vranë e zhdukur lufta, i zhduku një flamë vrastare, siç ishte gripi spanjoll. Autori tregon një ngjarje drithëruese të jetuar, ku gjyshes së tij i vdiqën shtatë fëmijët e saj brenda një jave ajo mbeti me duar në gji.

Edhe viti 1919 është vit luftime, pasi serbët nuk duan të largohen. Ata kanë vendosur karakollet e tyre brenda kufijve të vitit 1913 dhe kërkojnë të zotërojnë tre qafat, Qafë Buall, Qafë Murë dhe Qafë Mërkurth. Flama vrastare e gripit spanjoll vazhdon. Njëkohësisht vazhdon edhe eksodi i brendshëm nga fshatrat buzë kufirit, buzë Drinit të Zi për në thellësi në Katër Grykët e Dibrës.

Viti 1920 është viti i Shqipërisë në luftë. Lufton Vlora ndaj italianëve, Kopliku ndaj malaziasve dhe Dibra ndaj serbëve. Në Dibër luftohet që nga Luma në Steblevë. Në Dibër zhvillohet Kuvendi i Arrasit dhe dibranët marrin një vendim të rëndësishëm që të vetëçlirohen, që të luftojnë dhe t'i detyrojnë serbët që të zbrapsen nga trojet e tyre. Dhe kështu ndodhi. Luftëtarët dibranë të komanduar nga Elez Isufi dhe Isuf Xhelili i zbrapsën serbët tej kufirit. Në betejën e Salbastrës ra si hero Osman Paci, që e mbuloi me gjoksin e tij mitrolozin armik. Shëmbuj të tillë ka edhe të tjerë. Heroizmi masiv nuk përshkruhet.

E veçanta e këtij libri është paraqitja edhe e luftërave të njëpasnjëshme, edhe e eksodeve e shpërnguljeve masive të zhvilluara, edhe e epidemive e zisë së bukës që ishin shoqëruese gjatë këtyre nandë viteve. Mbijetesa e popullit ka qenë dhe mbetet karakteristika kryesore e tij ndër breza dhe ky është edhe shqetësimi i autorit që këto përpjekje titanike të popullit tonë t'i transmetohen brezave të rinj. Kanë kaluar 100 vjet, por duken si 100 ditë për ata që nuk harrojnë. Të ecim përpara, por të mos e harrojmë të kaluarën tonë të lavdishme. Ky është mesazhi kryesor që transmeton ky libër me vlera letrare dhe historike. Autori ka bërë një punë të jashtëzakonshme duke na sjellë në vëmendje udhëtimin titanik të të parëve, sakrificën dhe heroizmin, traditën dhe qëndresën heroike të paraardhësve tanë. Ky libër është një manual memoristik që duhet të lexohet nga secili dhe zë një vend nderi në çdo bibliotekë.

## DEKORIMI

*Kreu i shtetit vlerësoi me Titullin “Naim Frashëri” Ansamblin Artistik “Hazis Ndreu” - “Nderi i Kombit”*

# “MJESHTËR I MADH”, TITULLI MERITUAR PËR MUHARREM GJOKËN

- *“Në Dardhë dhe në Dibër, mbetet i papërsëritshmi ‘Nderi i Kombit’, Hazis Ndreu, emri i të cilit është gdhendur edhe sot, jo vetëm në kujtesën e secilit prej nesh, por edhe në ansamblin artistik që mban emrin e tij të madh dhe që drejtohet nga i biri, një krijues shumë i talentuar dhe koreograf i përmasave kombëtare, si Avni Ndreu”,-tha Presidenti Meta.*

**Nga Halil RAMA**

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta ka dekoruar me Titullin “Mjeshtër i Madh”, zotin Muharrem Gjoka – NËNKRYETAR I OBVL dhe president i Ansamblit Artistik “Hazis Ndreu: - “Nderi i Kombit”. Vetë motivacioni që mban dekorata: “Në vlerësim të veprimtarisë dhe mbështetjes së shumanshme në lartësimin e kulturës kombëtare, vlerave atdhetare, folklorit dhe muzikës popullore shqiptare, veçanërisht asaj dibrane, si dhe të kontributit të veçantë në zhvillimin dhe përparimin e vendit”, është vlerësimi më objektiv i rolit të këtij personaliteti dibran. Në fjalën e tij, kreu i shtetit do të vlerësonte se: “Prej vitesh pranë këtij grupimi artistik, si një dorë e ngrohtë, inkurajuese dhe mbështetëse, është një emër, i cili e nisi jetën e tij artistike si një talent i skenës dhe i valles dibrane dhe sot është president i këtij ansambli, ish-valltari virtuoz, një burrë Dardhe dhe Dibre, i vlerësuar edhe me Titullin ‘Nderi i Qarkut Dibër’, zoti Muharrem Gjoka. Roli i tij është i padiskutueshëm si artist dhe si njeri me zemër të madhe, me një kontribut më shumë se 50-vjeçar, duke gëzuar respektin e merituar në shoqëri, edhe si një humanist”. Muharrem Gjokën, si mishërues dhe përçues i fjalës së mençur dibrane u “diplomua” në kantieret e ndërtimit e asfaltimit të rrugëve në gjithë vendin, ku implementoi suksesshëm dijet e marra në “Universitetin e Dibrës”, leksionet e të cilit i përvetësoi nëpër odat e kuvendit dibrane....

Muharremi lindi në vitet e luftës, në Zall Dardhë, Dibër më 16 qershor të vitit 1943. Kaloi një fëmijëri të vështirë, por kjo e bëri më të fortë dhe të vetëdijshëm për të çarë rrugët e jetës.

Që në vitet e rinisë së tij u inkadrua në kantieret e ndërtimit të rrugëve, fillimisht në Kurbnesh dhe më pas në Skuraj, duke afirmuar cilësi të jashtzakonshme, të njeriut punëtor, korrekt, kreativ, por edhe drejtues i aftë.

Vitet e shërbimit ushtarak e largojnë prej ketu dhe mbrojtja e Atdheut e kërkon në Bilishtin e largët, në kufirin me Greqinë. Prej aty, ai shërben syshqiponjë edhe në Poçarin e largët në Leskovik, duke lënë gjurmët e mira të një patrioti të guximshëm dhe të një ushtari të djali të mirë. Sërisht pas shërbimit ushtarak në kantieret e ndërtimit, nga njëri fshat në tjetrin, si në Spaç, Shupal, Repts, Arrëz, Miliska, Fierzë, Gropa, Hapripte etj, Muharrem Gjoka stamponte çdo ditë me punën dhe sjelljen e tij, emrin e mirë, duke fituar një personalitet të padiskutueshëm.

Veçanërisht aftësitë e tij organizuese dhe drejtuese spikatën në vitet 1965-1955 në ndërtimin në një kohë rekord



të rrugës Qafë Bari – Fierzë dhe në vitin 1972 për asfaltimin e rrugës nacionale Peshkopi-Bulqizë.

Më pas, cilësitë e tij dhe vrulli i punës e afirmojnë edhe në Vaun e Dejes, madje aty kreu edhe studimet e shkollës së mesme në teknikumin e ndërtimit, duke rritur më shumë nivelin e tij jo vetëm profesional, por edhe intelektual.

Tashmë shkollimi i jep mundësinë që të zgjidhet në detyra të rëndësishme, duke qënë edhe drejtuesi i transportit. Jo rastësisht ai mori përsipër mjaft punë të mira në asfaltimin e rrugëve të Pukës, Shkodrës, Kukësit, Bulqizës, Rrëshenit, etj. Viti 1979, solli një shpërblim të gjithë këtij angazhimi dhe pune titanike, duke u pozicionuar në qytetin e Laçit, ku zgjedh edhe të banojë me familjen e tij të re dhe aty vijon të jetojë e kontribuoj për shumë vite. Këtu kryen edhe shkollën ekonomike, çka i mundësoi ngjitje në shkallët e karrierës deri Shef i Transportit të Ndërmarrjes së Asfaltimit që mbulopnte gjithë Veriunë Shqipërisë.

Pas viteve 90, kantieri ku ai punonte, Rruga Ura u privatizua, konkretisht në vitin 1994, por Muharremi vijoi të ishte sërish aty, si drejtues kantieri deri në vitin 2002. Dy vjet më pas, pra në vitin 2004, ai del në pension, por kjo shkëputje, asnjëherë s’e ndali atë në vrullin e përgjithshëm të angazhimeve dhe punëve të mira në dobi të familjes, vendlindjes dhe Shqipërisë.

Muharrem Gjoka, mbetet në ajkën e njerëzve të mirë dhe burrave të ndershëm e të përkushtuar, që përmes punës fjalës, sjelljes, por mbi të gjitha veprave të mëdha në shërbim të komunitetit, kanë një vend të merituar në shoqëri dhe komunitet.

Prej më shumë se dhjetë vitesh Muharrem Gjoka kryen funksionin e Presidentit të Grupit Artistik “Folk Alb Hazis



Ndreu”, i cili ka konkuruar dhe fituar çmime të para në festivale ndërkombëtare si në Ulqin, Tetovë e Prishtinë.

Po ashtu, që nga Kuvendi i shtatë i OBVL është zgjedhur Nënkrjetar i kësaj organizate, funksion të cilin e kryen me përkushtim të rrallë.

Aktiviteti i tij i mësipërm është vlerësuar me Çertifikatë Nderi nga Shoqata Kombëtare e Miqësisë dhe Bashkëpunimit Shqipëri-Itali; me Mirënjohje nga Qendra për Kulturë në Ulqin; me Çertifikatë Mirënjohje nga Ansambli Artistik “Kuvendi” Zall Dardhë, si dhe me Titullin “AMBASADOR I PAQES” nga Federata e Paqes Universale.

Me Vendimin Nr.03, datë 24.03.2021, Këshilli i Qarkut Dibër i ka dhënë Z.Muharrem Gjoka Titullin “NDERI I QARKUT DIBER”, me motivacionin: “Për përmbajtjen gjallë të vlerave etnokulturore, për kontributin e çmuar në mbështetjen dhe promovimin e vlerave të LANÇ, dhe si ish-drejtues në fushën e ndërtimit dhe infrastrukturës rrugore në gjithë vendin”. Pas gjithë këtyre titujve dhe vlerësimeve ai thotë se dekorimi nga Presidenti Meta me Titullin “Mjeshtër i Madh”, atë dhe Familjen e tij i bën më krenarë se kurrë.

Kreu i shtetit vlerësoi gjithashtu me Titullin “Naim Frashëri” Ansamblin Artistik “Hazis Ndreu”, me motivacionin: “Për veprimtarinë e shquar në mbartjen, ru-



ajtjen dhe përsosjen e traditave, folklorit dhe trashëgimisë së çmuar etnokulturore të trevës së Dibrës. Me mirënjohje për përkushtimin, shpirtin artistik dhe talentin që ka shpalosur në skenat shqiptare dhe të huaja këngët dhe vallet tradicionale, veshjet koreografike si dhe meloditë e pasura burimore të shumë brezave dibrane.”

Presidenti Meta dekoroi me titullin “Mjeshtër i Madh” edhe Avni Ndreun i cili është nderi i kulturës dibrane dhe qytetar nderi i Dibrës dhe prej shumë dekadash në krye të këtij ansambli, duke mbajtur gjallë dhe duke transmetuar sidomos tek brezat më të rinj, cilësi dhe vlera artistike të shumta.

“Në Dardhë dhe në Dibër, mbetet i papërsëritshmi ‘Nderi i Kombit’, Hazis Ndreu, emri i të cilit është gdhendur edhe sot, jo vetëm në kujtesën e secilit prej nesh, por edhe në ansamblin artistik që mban emrin e tij të madh dhe që drejtohet nga i biri, një krijues shumë i talentuar dhe koreograf i përmasave kombëtare, si Avni Ndreu”,-tha Presidenti Meta. Për kreun e shtetit “Talenti i Avni Ndreut, si koreograf, valltar e poet si dhe aftësitë e tij artistike organizuese i kanë dhënë ansamblit ‘Hazis Ndreu’ një emër të madh në botën e kulturës shqiptare dhe përtej saj, duke përfaqësuar denjësisht vendin tonë.”